

 POLICIA E SHKËBAJ	Titulli i Procedurës standarde: "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".		
Data e miratimit: Urdhër nr 1102, dt. 07.11. 2017	Nr:	Nr. Faqeve: 57	Rishikimi fundit: Nr. ____ datë __.__.201__
Referencë: - Germa "dh" e nenit 17; nenet 108 ; 109 ; 111 - 115 ; 122 dhe 133 i Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit". - Nenet 255; 257; dhe 259 të K. Pr. Penale . - Konventa Evropiane "Për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e degraduese".	Shpërndarë: Gjithë punonjësve të policisë		Fusha: Rendi dhe siguria

I. POLITIKA

Kjo politikë përcakton normat, kushtet dhe standardet për mbajtjen, trajtimin, sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe dënuarve me vendim të formës së prerë (deri në transferimin e tyre në IEVP) ambientet e dhomave të sigurisë të drejtorive/komisariateve vendore të policisë si dhe rregullat që zbatohen nga personeli policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria, deri në shqyrtimin e vendosjen e masës së sigurimit nga organet e gjykatës apo transferimin në IEVP.

II. QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj procedure është të përcaktojë :
 - a. Rregullat për ruajtjen, sigurimin dhe standardet e trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e komisariateve të policisë, shoqërimit e qëndrimit në seancat gjyqësore, qëndrimit e trajtimit në institucionet mjekësore, transferimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) e ambiente të tjera.
 - b. Normat e standardet që duhet të përmbushin ambientet për qëndrimin e trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar, për të bërë të mundur garantimin e lirive dhe të drejtave ligjore të ndaluarve/arrestuarve, sipas përcaktimeve të bëra në konventat ndërkombëtare, kushtetutën e aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

- c. Të drejtat ligjore dhe procedurale që kanë të arrestuarit/ndaluarit gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë deri të vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurisë nga gjykata.
- d. Dokumentacioni që plotësohet, mbahet dhe administrohet për personat e ndaluar/arrestuar në dhomat e sigurisë.
- e. Detyrimet e punonjësve të policisë për respektimin e garantimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të kësaj kategorie personash, deri në shqyrtimin e vendosjen e masave të sigurisë nga organet e gjykatës.
- f. Detyrimin e Policisë së Shtetit, strukturave të tjera shtetërore dhe atyre të pavarura që të marrin masa për mbrojtjen efektive të të drejtave të personave të privuar nga liria duke evidentuar, trajtuar dhe zgjidhur ankesë/kërkesat që bëhen nga personat e kësaj kategorie lidhur me kushtet e qëndrimit dhe trajtimin që u bëhet nga personeli policor.

III. PËRKUFIZIME.

Në kuptimin dhe përmbajtjen e këtij procedure, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime :

1. **Dhoma sigurie** - quhen ato ambiente të drejtorive/komisariateve të policisë që shërbejnë për mbajtjen, sigurimin e trajtimin e personave të ndaluar e arrestuar, deri në përcaktimin e masës së sigurimit nga gjykata, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, deri në transferimin e tyre në IEVP.
2. **I arrestuar/ndaluar** - quhet personi ndajë të cilit oficeret e policisë gjyqësore kanë marrë masën e arrestimit/ndalimit, sipas Kodit të Procedurës Penale.
3. **I huaj** - është çdo person i cili sipas legjislacionit shqiptar nuk është shtetas shqiptar.
4. **Përfaqësues ligjor**-quhet, kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili brenda kompetencave që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e të miturit nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të të miturit.
5. **Privim/kufizim i lirisë** : do të kuptojmë çdo formë të ndalimit, arrestimit, burgimit, shoqërimit apo vendosjen e personit në një ambient privues publik apo privat, nga i cili personi nuk lejohet të largohet sipas dëshirës së tij.
6. **Persona të privuar/kufizuar nga liria**,do të kuptojmë:
 - a. Personat ndaj të cilëve policia gjyqësore me iniciativë ka marrë masën e arrestimit në flagrancë sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, të cilët mbahen e trajtohen në dhomat e sigurisë të drejtorive dhe komisariateve të policisë, deri në shqyrtimin dhe caktimin e masës së sigurimit nga gjykata.
 - b. Personat ndaj të cilëve organet e prokurorisë kanë urdhëruar ndalimin e tyre sipas përcaktimeve dhe kritereve të Kodit të Procedurës Penale, të cilët mbahen e trajtohen në dhomat e sigurisë të drejtorive dhe komisariateve të policisë, deri në shqyrtimin dhe caktimin e masës së sigurimit nga gjykata.

- c. Personat ndaj të cilëve gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur masën e dënimit me burim në mungesë, i cili ekzekutohet nga shërbimi i policisë gjyqësore në zbatim të urdhrimit të prokurorisë “Për ekzekutimin e vendimit penal”.
 - d. Personat ndaj të cilëve punonjësit e policisë në zbatim të kërkesave të neneve 108/4, 109 dhe 122 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, realizojnë shoqërimin në ambientet e njësive policore ose organet urdhërdhënëse.
7. **Person i rritur i përshtatshëm** – quhet një nga prindërit, një i afërm, kujdestari apo një person tjetër që normalisht është përgjegjës për tu kujdesur për personat me çrregullime/dobësi mendore si dhe për të miturit një person tjetër me përvojë në trajtimin e këtyre personave (jo punonjës police), si dhe në mungesë të sipërpërmendurve një i rritur i përgjegjshëm mbi 18 vjeç (jo punonjës policie).
 8. **I dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë** – quhet personi ndaj të cilit gjykata ka vendosur me vendim të formës së prerë dënimin me burgim në mungesë dhe ky vendim ekzekutohet nga policia gjyqësore duke bërë ndalimin e personit e më pas transferimin e tij në IEVP.
 9. **Punonjës policie i nivelit të parë drejtues** – quhet punonjësi i policisë i cili mban gradën nënkomisar, komisar dhe kryekomisar.
 10. **Epror** – quhet punonjësi i policisë i cili mban funksion dhe gradë më të lartë se të tjerët.
 11. **Titullar** – quhet drejtuesi i drejtorisë vendore të policisë dhe drejtuesi i komisarariatit të policisë.

IV. PARIME TE PËRGJITHSHME

1. Respektimi i të drejtave e lirive njerëzore.

- 1.1. Trajtimi i personave të ndaluar/arrestuar në dhomat e sigurisë të drejtorive/komisariateve të policisë, është i paanshëm, i njëjlojtë dhe i barabartë për të gjithë dhe kryhet pa diskriminim për shkak të ngjyrës, racës, etnisë, gjuhës, fesë, gjinisë, origjinës shoqërore, moshës, paaftësisë fizike apo përkatësisë së tyre seksuale.
- 1.2. Trajtimi i të arrestuarve/ndaluarve në kujdesin dhe mbikëqyrjen e punonjësve të Policisë Shtetit është në përputhje të plotë me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në Konventat Evropiane, OKB-së, Kushtetutën e Republikës Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për të drejtat e njeriut e në veçanti për ata që u privohet liria.
- 1.3. Në ambientet e dhomave të sigurisë dhe ambiente të tjera të Policisë së Shtetit ndalohet përdorimi i torturës, dhunës, trajtimi degradues, diskriminues, jo human apo ç’njerëzor, përfshirë dhe dhunën verbale si kërcënime, fyerje e cila krijojnë përshtypjen dhe imazhin e frikës, pasigurisë për jetën e shëndetin e të ndaluarve e arrestuarve apo dhe familjarëve të tyre.

- 1.4. Ndalohet përdorimi i forcës ndaj të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e dhomave të sigurisë me përjashtim të rasteve të përcaktuara në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe në këtë procedure.
- 1.5. Punonjësi i policisë nuk duhet ti shkaktojë të ndaluarit/arrestuarit keqtrajtim degradues fizik apo mendor, si dhe kërkon respektimin e të gjitha rregullave dhe procedurave përkatëse që kanë të bëjnë me ndalimin, arrestimin, marrjen në pyetje dhe trajtimin e tyre.
- 1.6. Çdo rast i konstatimit të ushtrimit të dhunës, forcës lënduese ndaj këtyre personave duhet të raportohet tek eprori i drejtpërdrejtë dhe drejtuesi i njësisë policore apo ai që e zëvendëson, ky i fundit merr të gjitha masat për dhënien e ndihmës mjekësore të dëmtuarit, vlerësimin e trajtimin e rastit sipas rregullores së disiplinës apo kryerjen e veprimeve hetimore/procedurale e referimin në organin e prokurorisë.
- 1.7. Në ambientet e dhomave të sigurisë të arrestuarve/ndaluarve u garantohet dhe ofrohet shërbim shëndetësor falas nga personeli mjekësor i drejtorisë/komisariatit të policisë si dhe kundrejt pagesës dhe nga mjekë të tjerë të zgjedhur prej tyre.
- 1.8. Dhomat e Sigurisë të Policisë së Shtetit, funksionojnë në përputhje të plotë me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale dhe nën mbikëqyrjen e kontrollin e drejtpërdrejtë të prokurorit.
- 1.9. Të ndaluarve dhe arrestuarve u krijohen kushte jetese të përafërta me ato të jetës së shtetasve të tjerë të lirë, sipas normave të Konventës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Ç'njerezore e Degraduese, të KE-së.
- 1.10. Të arrestuarit/ndaluarit i garantohet e drejta të paraqesin ankesa dhe kërkesa lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme për trajtimin e respektimin e të drejtave të tyre nga personeli policor si dhe i krijohen mundësitë për ushtrimin e kësaj të drejte. Ankesat dhe kërkesat bëhen në mënyrë individuale.
- 1.11. Për personat me çrregullime apo dobësi të shëndetit mendor detyrimisht sigurohet prania e një personi të rritur të përshtatshëm, i cili merr pjesë në të gjitha fazat kur specialisti i policisë/oficeri i policisë gjyqësore/prokurori i shpjegon të arrestuarit/ndaluarit arsyen e marrjes së kësaj mase, procedurat që do të zbatohen, të drejtat që ka në këtë fazë si dhe gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje pavarësisht se mund të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues ligjor.
- 1.12. Për shtetasit e huaj garantohet përmbushja dhe zbatimi i detyrimeve të konventave mbi shërbimin konsullor, duke kryer njoftimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe përfaqësive diplomatike dhe konsullore të akredituara në vendin tonë sipas përkatësisë së shtetësisë të tyre.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PRANIMIN, REGJISTRIMIN, KONTROLLIN, TRANSFERIMIN DHE LIRIMIN E TË ARRESTUARVE/NDALUARVE

1. Pranimi i të arrestuarve/ndaluarve.

Pranimi i të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e dhomave të sigurisë, bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, kundrejt dokumentacionit të mëposhtëm :

1.1 Për të arrestuarin/ndaluarin :

- a) Procesverbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurori, urdhri i ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor.
- b) Procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale të cilat janë konstatuar dhe gjetur gjatë kontrollit.
- c) Një nga dokumentet zyrtare të identifikimit.

1.2 Për të dënuarit me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë :

- a) Vendimi i formës së prerë të gjykatës për dënimin me burgim të personit në mungesë.
- b) Kopje të urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.
- c) Procesverbal të ekzekutimit të urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor penal.
- d) Procesverbal për kontrollin personal dhe sendet personale.
- e) Një nga dokumentet zyrtare të identifikimit.

2. Kontrolli i të arrestuarit/ndaluarit.

2.1 Pas arrestimit/ndalimit (përpilimit të procesverbaleve përkatëse) dhe para se të akomodohet në dhomat e sigurisë personit përkatës i bëhet kontroll nga oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin apo ndalimin.

2.2 Kontrolli i personit bëhet duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe integritetin fizik e moral të personit dhe mbrojtjen e personit objekt kontrolli. Kontrolli kryhet gjithmonë me praninë e një dhe më shumë personave të tjerë të pranishëm, të cilët kanë të njëjtën gjini me personin që kontrollon.

2.3 Punonjësit e policisë para se të kryejnë kontrollin e personit duhet të :

- a) Vlerësojnë situatën e rrezikut gjatë kontrollit.
- b) Tregojnë kujdes për të dalluar çdo veprim, sjellje, qëndrim apo çdo gjë tjetër që tregon se personi vuan nga ndonjë sëmundje mendore, apo gjendje shëndetësore e veçantë.

3. Kontrolli sipërfaqësor i rrobave të trupit dhe rregullat e kryerjes së tij.

3.1 Ky kontroll konsiston në prekjën me dorë të sipërfaqes së rrobave/veshjeve të personit që kontrollon.

- 3.2 Kontrolli sipërfaqësor kryhet në ambientet e njësive policore si : zyra pune, dhomën e punës të përgjegjësit të dhomave të sigurisë apo ambiente të tjera të përshtatshme që nuk shikohen nga publiku apo punonjës të tjerë të policisë.
- 3.3 Paraprakisht personit që do të kontrollohet i kërkohet që të nxjerrë vetë e heqë nga veshjet apo trupi sende të tilla që përbëjnë rrezik për sigurinë në këto ambiente, si : brisqe, thika, kaçavida, copa metali, pasqyra, krehër, kartëmonedha, spango, dokumentua të ndryshme, lidhëse këpucësh, rripi i pantallonave, zinxhirë, varëse, unaza, çelësa, byzylykë, telefon celularë, shkrepëse, qese plastike, medikamente mjekësor, etj.
- 3.4 Në rastet kur i ndaluar/arrestuari refuzon të dorëzojë vetë sendet apo materialet që ka në veshje e trup apo pretendon se nuk ka asgjë me vete, ndaj tij ushtrohet kontroll jashtë vullnetit të tij duke prekur me duar sipërfaqen e rrobave, xhepat etj.
- 3.5 Të gjithë sendet e konstatuara gjatë kontrollit sipërfaqësor personal, pasqyrohen në “procesverbalin e kontrollit personal” i cili hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga oficeri policisë gjyqësore, përgjegjësi i dhomave të sigurisë apo një punonjës/se tjetër e policisë dhe i arrestuari/ndaluar.
- 3.6 Në këtë procesverbal pasqyrohen dhe vlerat monetare që mund të ketë vete personi i ndaluar/arrestuar duke i pasqyruar ato sipas prerjeve dhe numrave të serisë që kanë dhe me pëlqimin e personit ato u dorëzohen pjestarëve të familjes, kundrejt nënshkrimit.
- 3.7 Kopje të këtij procesverbali i jepet të arrestuarit/ndaluarit, oficerit të policisë gjyqësore dhe përgjegjësit të dhomave të sigurisë, ky i fundit e administron në fashikullin personal të arrestuarit/ndaluarit.
- 3.8 Për kontrollin e të miturve kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit.

4. Kontrolli i imët dhe rregullat e kryerjes së tij.

- 4.1 Kontrolli i imët kryhet në rastet kur vlerësohet si i nevojshëm për të hequr sendin/et e ndaluar dhe se personi i arrestuar/ndaluar mund ta ketë fshehur atë, si dhe kur :
 - a) Nga kryerja e kontrollit sipërfaqësor të rrobave nuk është arritur heqja e bllokimi i të gjitha sendeve apo materialeve të tjera që përbëjnë rrezik.
 - b) Kur dyshohet se këto sende personi i fsheh në pjesë të tjera të veshjeve apo të trupit.
 - c) Sendet e materialet nuk janë dorëzuar të gjitha sipas kërkesës të bërë nga oficeri policisë gjyqësore apo përgjegjësi i dhomave të sigurisë.
- 4.2 Kontrolli i imët nuk kryhet kur nuk ka arsye të mendohet se në trupin e personit mbahen të fshehur sende apo materiale që paraqesin rrezik.
- 4.3 Kontrolli i imët kryhet në vende të caktuara që nuk shihen nga publiku, ku personi i ndaluar ose i arrestuar nuk shihet nga persona të tjerë dhe përfshin heqjen e më shumë se veshjeve të jashtme të personit si : këpucë, çorape dhe veshje të tjera të jashtme e të brendshme.

- 4.4 Ky kontroll kryhet gjithmonë në ambiente të posaçme dhe të mbyllura të njërive policore si: dhoma e vizitave mjekësore dhe dhoma / zyra e punës të përgjegjës të dhomave të sigurisë.
- 4.5 Ambientet ku kryhet kontrolli duhet të sigurojnë kushte të përshtatshme të ndriçimit dhe temperaturës sipas stinës.
- 4.6 Kontrolli i imët kryhet nga punonjësit e shërbimit të policisë gjyqësore (që kanë bërë ndalimin apo arrestimin) gjithmonë nga persona me të njëjtin seks si dhe me dy persona të pranishëm.
- 4.7 Kontrolli kryhet duke marrë parasysh ndjeshmërinë dhe cënueshmërinë e personit në këto rrethana dhe duhet bërë çdo përpjekje e arsyeshme për të siguruar bindjen e bashkëpunimit të personit dhe për të minimizuar krijimin e situatave të sikletshme apo të përdorimit të forcës.
- 4.8 Personave që i nënshtrohen kontrollit të imët nuk u duhet kërkuar të heqin të gjitha rrobat e tyre në të njëjtën kohë, p.sh një burrë duhet lejuar të veshë këmbësorë e tij para se të heqë pantallonat, dhe një grua duhet lejuar të veshë bluzën e saj dhe veshjet e jashtme përpara se të heqë rroba të tjera.
- 4.9 Kur është e nevojshme, personit mund t'i kërkohej të ngrejë duart ose t'i mbajë këmbët hapur dhe të përkulet para, në mënyrë që të bëhet një këqyrje pamore e zonës gjentiale dhe anale, duke evituar dhe mos pasur kontakt fizik me ndonjë pjesë të tillë të trupit.
- 4.10 Nëse gjatë kontrollit gjenden sende, prova materiale, personit i kërkohej t'i dorëzojë ato. Nëse gjenden sende në pjesë intime të trupit përveç gojës dhe personi refuzon t'i dorëzojë ato, heqja e tyre bëhet e detyrueshme.
- 4.11 Kontrolli i imët kryhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe sapo mbaron procedura e kontrollit, personi i kontrolluar lejohet të vishet.
- 4.12 Në rast se gjatë kontrollit të imët lind e nevojshme bllokimi apo sekuestrimi i sendeve personale apo të veshjeve të personit, oficeri i policisë gjyqësore dokumenton një veprim të tillë sipas procedurave përkatëse dhe vë në dijeni personin që kontrollohet. Në këtë rast njëzia policore merr masa për dhënien e rrobave/veshjeve të tjera për të ndaluarin/arrestuarin të cilat mund të sigurohen nga familja dhe në rast të kundërt i siguron vetë – policia.
- 4.13 Për kontrollin e të miturve kërkohej edhe prania e prindit ose e kujdestarit.

5. Kontrolli i anësive/intim dhe rregullat për kryerjen e tij.

- 5.1 Kontrolli i anësive (kontrolli intim) kryhet vetëm me vendim të organeve të gjykatës dhe ndërmerret si masë e fundit ndaj personit që dyshohet se fsheh prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale.
- 5.2 Gjatë kryerjes së kontrollit të anësive zbatohen rregullat e mëposhtme:
 - a) Kontrolli intim konsiston në këqyrjen fizike të pjesëve intime dhe të hapura të personit (hundët, veshët, anusit apo vagjinës dhe gojën.)
 - b) Kontrolli intim kryhet në rastet kur ka arsye të bazuara të besohet se:

- i. Personi ka fshehur sende apo materiale të tjera që përbëjnë prova materiale të veprës penale, apo i përkasin veprës penale.
 - ii. Personi fsheh sende të cilat mund të shkaktojnë plagosje/dëmtime fizike të arrestuarit/ndaluarit apo personave të tjerë.
 - iii. Personi ka fshehur substanca apo medikamente si drogë të kategorisë A për shpërndarje apo eksportim si dhe sende të tjera të ndaluara.
 - iv. Kur ky kontroll çmohet si mjeti i vetëm dhe i fundit për të bllokuar/sekuestruar e hequr sendet e paligjshme dhe parandaluar rrezikun që mund ti kanoset vetë personit apo personave të tjerë.
- c) Kryhet vetëm në ambiente e salla të veçanta të institucioneve mjekësore (qendrave spitalore apo ambulancave) të pajisura me mjetet e nevojshme për kontroll. Ky kontroll kryhet nga mjek apo infermier të kualifikuar.
 - d) Kontrolli intim i personave të mitur kryhet në prani të prindërit apo kujdestarit ligjor.
 - e) Personit që do i nënshtrohet kontrollit i shpjegohen arsyet përse ai konsiderohet i nevojshëm, para kryerjes së kontrollit.
 - f) Gjatë kontrollit intim ndalohet prezenca e personave të tjerë që janë me gjini të kundërt, duke përjashtuar personat që janë personel mjekësor.
 - g) Minimalisht dy persona (përveç personit të kontrolluar) duhet të jenë të pranishëm gjatë kontrollit. Kontrolli kryhet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë dhe cënueshmërisë së personit në këto rrethana.
- 5.3 Kontrolli intim ndaj personit me aftësi të kufizuara mendore, duhet të kryhet vetëm në praninë e një të rrituri të përshtatshëm me të njëjtin seks, përveç rasteve kur vetë personi kërkon praninë e një të rrituri të caktuar të seksit të kundërt. Kontrolli intim mund të kryhet dhe pa praninë e një të rrituri vetëm në raste të ngutshme e urgjente, kur vonesat në kryerjen e kontrollit mund të shkaktojnë rrezik të rëndë për vetë personin e arrestuar/ndaluar ose për persona të tjerë.

6. Përdorimi i forcës gjatë kryerjes së kontrollit.

- 6.1 Në rast se personi nuk i bindet kërkesës së ligjshme të personelit policor/oficerit policisë gjyqësore për të dorëzuar sendet apo materialet e tjera që mban në trup, refuzon të heqë teshat e trupit, refuzon të këqyret e kontrollohet, ndaj tij përdoret forca.
- 6.2 Forca duhet të jetë e arsyeshme dhe ti përgjigjet nivelit të kundërshtimit apo veprimeve të tjera të personit të arrestuar/ndaluar dhe përdoret deri në arritjen e qëllimit të kontrollit.
- 6.3 Para përdorimit të forcës personi i ndaluar/arrestuar paralajmërohet se do të përdoret forca dhe arsyet e përdorimit të saj.
- 6.4 Për përdorimin e forcës nga ana e oficerit policisë gjyqësore/specialisti i policisë, mbahet një procesverbal ku tregohet arsyet e përdorimit të forcës, natyra e forcës së përdorur, punonjësit e policisë që kanë përdorur forcën, veprimet e reagimet e të arrestuarit/ndaluarit, nëse të arrestuarit/ndaluarit i janë shkaktuar lëndime apo dëmtime të tjera fizike, nëse janë dëmtuar personeli policor apo ai mjekësor, etj.

- 6.5 Procesverbali i përdorimit të forcës nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit dhe kopje të tij administrohen në fashikullin e dokumenteve të arrestuarit/ndaluarit që mbahet në dhomat e sigurisë.

7. Verifikimi paraprak dhe kontrolli mjekësor.

- 7.1 Para sistemimit/akomodimit në sistemin e dhomave të sigurisë, një punonjës policie i nivelit të parë drejtues i shërbimeve të rendit publik, specialisti i shërbimit të sallës së komandimit/ndihmës specialisti për informacionin dhe mjeku i policisë, kryejnë intervistimin, verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarit/ndaluarit nëse ka shenja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtimit, sëmundje të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë mjekësore apo ankesa të tjera të kësaj natyre.
- 7.2 Detyrimisht në këtë moment sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 12 orë pas ndalimit/arrestimit kryhet kontrolli/vizita mjekësore nga mjeku apo ndihmësmjeku i drejtorisë/komisariatit policisë.
- 7.3 Në rastet e refuzimit të kryerjes së kontrollit mjekësor, nga ana e personave të përcaktuara në germën "a" të kësaj pike, dokumentohet shënimi që "refuzon të vizitohet" dhe nënshkruhet prej tyre (në rastet kur nuk ka shenja të dukshme të dëmtimeve apo të sëmundjeve).
- 7.4 Për të miturit ky kontroll/vizitë kryhet me pëlqimin e prindërve apo të kujdestarit.
- 7.5 Në përfundim të këtij procesi punonjësit e përmendur në germën "a" të kësaj pike gjithçka të konstatuar e pasqyrojnë në një procesverbal verifikimi – konstatimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë punonjësit e policisë që janë përfshirë në verifikim/konstatim dhe vendoset në dosjen e të ndaluarit/arrestuarit.

8. Marrja e gjurmëve daktiloskopike dhe fotografimi.

- 8.1 Menjëherë pas kryerjes së arrestimit/ndalimit, kryen veprimet për marrjen e të dhënave të mëposhtme :
- a) Shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
 - b) Dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- 8.2 Marrja e gjurmëve dhe bërja e fotografive kryhet nga specialistë/ndihmës specialistë të shërbimit të Policisë Shkencore të drejtorisë/komisariatit të policisë, sipas rregullave dhe procedurave të punës të miratuara për këtë qëllim.
- 8.3 Personeli përgjegjës i policisë shkencore përveç sa hedh në bankën qendrore elektronike gjurmët daktiloskopike, formularin e figurës së përshkruar dhe fotografitë, kopje të formularit të figurës së përshkruar ja vë në dispozicion përgjegjësit të dhomave të sigurisë jo më vonë se 48 orë nga arrestimi/ndalimi.

9. Akomodimi i të arrestuarit/ndaluarit.

- 9.1 Fillimisht nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, plotësohet regjistri i personave të arrestuar/ndaluar, duke pasqyruar të dhëna për : emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, adresën e vendbanimit, përshkrimin e pamjes së jashtme, puna që kryen, vepra penale për të cilën është arrestuar/ndaluar, rrethana të shkurtra për kryerjen e veprës penale, ora, data dhe vendi ku është arrestuar/ndaluar, zyra apo ambienti i policisë ku është mbajtur, të dhëna për punonjësin e policisë i cili ka kryer arrestimin/ndalimin, datën e lirimit apo transferimit në IEVP.
- 9.2 Para se personi arrestuar/ndaluar të vendoset në dhomën e sigurisë, kjo e fundit kontrollohet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë për të verifikuar ekzistencën e kushteve lidhur me :
- a) Ekzistencën e kushteve të plota të sigurisë të dyerve, dritareve, zgarës së hekurit, xhamave, dyshemesë, bravat, ndriçimin, etj.
 - b) Kushte të plota higjienë dhe pastërtie dhe pa parazitë.
 - c) Të jetë e pajisur me shtrat të sigurt dhe që nuk paraqet rrezik për vetëdëmtim.
 - d) Materiale të tilla për fjetje si dyshekë të pastër e të përshtatshëm, batanije jastëk.
 - e) Mjete të domosdoshme për larje, pastrim e dezinfektim.
 - f) Mos ekzistencën e asnjë sendi tjetër (përveç atyre të përcaktuara në këtë procedure) me të cilin i arrestuari/ndaluari mund të cenojë sigurinë, jetën, shëndetin e tij apo të personave të tjerë (çakmakë, shkrepse, drogë, armë) etj.
- 9.3 Kur konstatohen mangësi të kushteve të sigurisë, apo kur kushtet higjienike nuk përmbushin standardet e kërkuara dhe përcaktuara në këtë procedure, i arrestuari/ndaluari futet/akomodohet në dhomë tjetër e cila plotëson kushtet, si dhe njoftohet eprori direkt dhe merren masat për eliminimin e mangësive.
- 9.4 Të ndaluarit/arrestuarit femra mbahen në dhoma të veçanta të ndarë nga të ndaluarit e arrestuarit meshkuj.
- 9.5 Të ndaluarit e arrestuarit e mitur (14 - 18 vjeç) akomodohen, mbahen e trajtohen në dhoma të ndarë nga personat me moshë madhore.
- 9.6 Gjatë sistemimit të tyre në dhoma duhet të mbahet parasysh që të mos vendosen në një dhomë bashkautorët e të njëjtës vepër penale si dhe të ndaluar apo arrestuar të grupeve rivale. Në raste të tilla merret mendimi i prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore që ka kryer veprimet.

10. Fashikulli/dosja e të arrestuarit /ndaluarit.

- 10.1 Për çdo person të arrestuar/ndaluar që mbahet në dhomat e sigurisë, çelet fashikulli i cili merr për numër - numrin rendor që ka emri i tij në regjistrin e personave të arrestuar/ndaluar, i cili gjatë periudhës që personi mbahet në këto ambiente duhet të plotësohet me këto dokumente :
- a) Procesverbali i arrestimit në flagrancë ose urdhri për ndalimin.
 - b) Kopje të urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.
 - c) Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

- d) Procesverbali për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për dënimin e tij me burgim së bashku me kopjen e këtij vendimi, (për të dënuarit në mungesë me burgim).
- e) Procesverbali i kontrollit fizik/personal.
- f) Formularin e identifikimit me foto dhe gjurmët e gishtërinjve.
- g) Certifikata personale e gjendjes civile, ose një nga dokumentet e identifikimit (kartë të identitetit, pasaportë, etj).
- h) Kartela mjekësore me shënimet përkatëse të mjekut.
- i) Procesverbal për dorëzimin e sendeve personale të arrestuarit/ndaluarit kur lihet i lirë apo transferohet në IEVP, jepen familjarëve apo të afërmve të personit, si dhe organit të prokurorisë kur këto të fundit kërkojnë një gjë të tillë.

11. Rregullat për mbajtjen e trajtimin e sendeve personale.

- 11.1 Sendet personale që gjenden gjatë kontrollit personal të arrestuarit/ndaluarit sipas pikës "2" dhe "3" të Kreut të V - të, përveç sa pasqyrohen në procesverbalin e kontrollit personal, bëhet evidencimi dhe në regjistrin e sendeve personale.
- 11.2 Sendet personale ruhen në rafte apo kasaforta të mbyllura në dhomën e punës së përgjegjës të dhomave të sigurisë, brenda sistemit të dhomave të sigurisë, në kushte që mos dëmtohen nga agjentët atmosferikë apo veprime të tjera. Në këto rafte apo kasaforta ndalohet mbajtja e ushqimeve.
- 11.3 Në këto ambiente mbahen dhe tesha e veshje rezerve për të ndaluarit/arrestuarit.
- 11.4 Ndalohet mbajtja në këto ambiente e sendeve personale që janë sekuestruar apo përbëjnë provë materiale në procesin penal.
- 11.5 Vlerat monetare që u gjenden të ndaluarve/arrestuarve gjatë kontrollit dorëzohen brenda 24 orëve kundrejt mandatit të arkëtimit në sektorin e financës të komisariatit/drejtorisë vendore të policisë. Kopja e mandatit të arkëtimit bashkëlidhet procesverbalit të kontrollit personal dhe ruhet në fashikullin e të ndaluarit/arrestuarit.
- 11.6 Kur sendet personale të ndaluarit/arrestuarit kërkohen nga organi i prokurorisë apo gjykata, përpilohet procesverbal në dy kopje i nënshkruar nga dorëzuesi dhe marrësi (kërkuesi). Një kopje e procesverbalit mbahet në fashikullin e të ndaluarit/arrestuarit.
- 11.7 Me pëlqimin e të ndaluarit/arrestuarit, sendet personale u jepen pjesëtarëve të familjes së tij kundrejt nënshkrimit të marrjes në dorëzim në një procesverbal të posaçëm dorëzimi, pasi të jetë marrë më parë pëlqimi i prokurorit.
- 11.8 Kur ndajë të arrestuarit/ndaluarit gjykata vendos si mase sigurimi "arrest në burg", sendet personale i kalojnë me firmë punonjësit të policisë që është përgjegjës për shoqërimin e transferimin e të ndaluarit/arrestuarit dhe më pas personit përgjegjës që merr në dorëzim të arrestuarin/ndaluarin në IEVP.

- 11.9 Në rast se ndaj të arrestuarit/ndaluarit vendoset një masë tjetër sigurimi e ndryshme nga ajo me “arrest në burg”, sendet personale i dorëzohen personit kundrejt nënshkrimit në procesverbalin e dorëzimit dhe në regjistrin përkatës.
- 11.10 Në rast se i arrestuari/ndaluari vdes gjatë kohës së qëndrimit në ambientet e dhomave të sigurisë, sendet personale të tij pas miratimit të prokurorit u jepen familjarëve kundrejt nënshkrimit përkatës.

12. Lirimi i të arrestuarve/ndaluarve.

- 12.1 Lirimi i të arrestuarve/ndaluarve bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, në rastet kur :
- a. Jepet urdhër me shkrim nga prokurori “Për lirimin e menjëhershëm” në zbatim të nenit 257 të K. Pr. Penale.
 - b. Kur gjykata gjatë seancës për shqyrtimin/vlerësimin e masës së sigurimit ka vendosur masa të tjera të ndryshme nga ajo me “arrest në burg”. Në këtë rast lirimi i të arrestuarit/ndaluarit bëhet direkt nga salla e gjyqit duke ju hequr prangat lidhëse. Për këtë qëllim përgjegjësi i patrullës së shërbimit policor kërkon nga gjykata kopje të vendimit të shkurtuar, vihet në dijeni prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore përkatës për nxjerrjen e urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal dhe përpilimin e procesverbalit të ekzekutimit të vendimit për caktimin e masës së sigurisë.
Në këtë rast deri në përfundimin e kryerjes së këtyre veprimeve personi shoqërohet nga gjykata për në ambientet e drejtorisë/komisariatit të policisë duke u mbajtur në ambientet e pritjes apo zyrat e punës së specialistëve të policisë.
 - c. Kur ka përfunduar afati ligjor i qëndrimit të tij si i arrestuar/ndaluar në këto ambiente sipas përcaktimit të nenit 259, pika 5 të K. Pr. Penale. Në rast se dhe pas këtij afati gjykata nuk ka kryer shqyrtimin dhe vendosjen e një prej masave të sigurimit, i arrestuari/ndaluari lirohet duke u nxjerrë menjëherë nga ambienti i dhomave të sigurisë. Në këtë rast vihet në dijeni titullari i drejtorisë/komisariatit të policisë, oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin/ndalimin dhe prokurori i prokurorisë së rrethit gjyqësor.
- 12.2 Mbas lirimit personit të arrestuar/ndaluar i dorëzohen të gjitha sendet personale sipas procesverbalit të kontrollit personal duke përpiluar një procesverbal dorëzimi e nënshkruar nga marrësi në dorëzim dhe përgjegjësi i dhomave të sigurisë. Ky procesverbal vendoset në fashikullin e të arrestuarit/ndaluarit.

13. Transferimi i të arrestuarve/ndaluarve.

- 13.1 Transferimi i personit të arrestuar/ndaluar nga dhomat e sigurisë për në IEVP të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (D.P.B), bëhet menjëherë pasi gjykata të ketë vendosur si masë sigurimi “arrest në burg”. Transferimi dhe dorëzimi bëhet brenda orarit zyrtar të pranimeve të shpallura nga Drejtoria e

- Përgjithshme e Burgjeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta të nënshkruara midis drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe D.P.Burgjeve.
- 13.2 Transferimin i të dënuarit me vendim të formës së prerë për në IEVP, bëhet menjëherë, sipas urdhrorit për ekzekutimin e vendimit të nxjerrë nga prokurori.
- 13.3 Transferimi i të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “arrest në burg” bëhet në IEVP-të që gjenden në juridiksionin e drejtorisë/komisariatit të policisë apo sipas përcaktimit të bërë nga D.P.Burgjeve.
- 13.4 Transferimi dhe dorëzimi i të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “arrest në burg” bëhet i shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :
- a) Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”
 - b) Procesverbali i ndalimit ose i arrestimit në flagrancë.
 - c) Procesverbali i kontrollit personal.
 - d) Formularin e identifikimit me fotot dhe gjurmët e gishtërinjve.
 - e) Dokumentin e identifikimit.
 - f) Dokumentin e kontrollit mjekësor (kartela mjekësore e plotësuar nga mjeku i drejtorisë/komisariatit policisë apo mjekë të tjerë të qendrave spitalore).
- 13.5 Për të arrestuarit/ndaluarit të seksit femër përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën “13.4” të pikës 13 në Kreun e V- të, nevojitet dhe dokumenti i vizitës/kontrollit gjinekologjik të përpiluar nga një mjek i këtij shërbimi.
- 13.6 Të arrestuarit/ndaluarit nuk mund të transferohen në IEVP në rast se nuk është plotësuar dokumentacioni i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f” të parashikuar në pikën “13.4” të pikës 13 në Kreun e V- të.
- 13.7 Kopje të procesverbalit për dorëzimin e të arrestuarit/ndaluarit dhe të sendeve personale në IEVP, dorëzohen tek përgjegjësi i dhomave të sigurisë nga përgjegjësi i patrullës së shoqërimit, i cili administrohet në fashikullin përkatës.

VI. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË NDALUARVE / ARRESTUARVE

1. Të drejtat e të arrestuarit/ndaluarit.

- 1.1 Të njihet me shkakun /arsyen e ndalimit apo arrestimit dhe të drejtat ligjore që ka në këtë fazë të procesit. Për shtetasit e huaj ky komunikim të realizohet në gjuhën e tyre amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi.
- 1.2 Të mbrohet e përfaqësohet me avokat, duke e zgjedhur atë vetë por jo më shumë se dy mbrojtës, ose të caktuar nga prokurori sipas përcaktimeve të nenit 255 të K. Pr. Penale. Takimet dhe konsultimet e personit të arrestuar/ndaluar me avokatin mbrojtës zhvillohen në mënyrë private dhe pa praninë e asnjë personi tjetër.
- 1.3 Të miturve u sigurohet asistencë dhe ndihmë e një psikologu gjatë arrestimit/ndalimit dhe qëndrimit në këto ambiente.
- 1.4 Të miturve u sigurohet mbrojtje juridike e detyruar.

- 1.5 Të njoftojë një pjesëtar të familjes, një të afërm apo persona të tjerë të zgjedhur prej tyre duke bërë telefonatë në prezencë të punonjësve të policisë për vendndodhjen, situatën në të cilën është, në rastet e transferimeve nga një komisariat policie në tjetrin, kur transferohet në IEVP, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë refuzohet nga të ndaluarit apo arrestuarit e moshës madhore.
- 1.6 Të marrë takim në çdo kohë me avokatin mbrojtës, kujdestarin ligjor, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, sa herë që kërkohet nga këta të fundit.
- 1.7 Të mos mbaheni në ambientet e policisë (dhomat e sigurisë) për më shumë se 48 - orë nga momenti i arrestimit/ndalimit deri sa të dalë para një gjyqtari.
- 1.8 Shtetasit e huaj të marrin kontakt me përfaqësues të Përfaqësisë Diplomatike të vendit të tij dhe në mungesë të tyre me përfaqësues të atij shteti që ka marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shtetit përkatës. Është detyrim i Policisë së Shtetit të bëjë njoftimin e menjëhershëm të Përfaqësisë përkatëse Diplomatike.
- 1.9 Ti nënshtrohet vizitave dhe ekzaminimeve mjekësore të një mjeku/ndihmës mjeku i njësisë policore, mjekë të tjerë të specializuar apo të zgjedhur dhe shpërblyer nga i arrestuari/ndaluari.
- 1.10 Të përfitojë shërbim mjekësor falas gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e sigurisë sipas nevojës dhe gjendjes shëndetësore, duke ruajtur konfidencialitetin.
- 1.11 Të mos i ndërpriten trajtimi i mëparshëm me medikamente mjekësore.
- 1.12 Të njihen me rregullat e brendshme të qëndrimit në dhomat e sigurisë dhe me detyrat e tij.
- 1.13 Të miturit (14 - 18 vjeç) mbahen e trajtohen të ndarë nga personat madhorë, në dhoma më vete, brenda sistemit të dhomave të sigurisë.
- 1.14 Ti jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, kontrollit personal dhe kopje të deklaratës (*Model 3*) për njohjen me të drejtat e tij.
- 1.15 Të mos japë shpjegime për arsyet e ndalimit/arrestimit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale personelit policor të shërbimit.
- 1.16 Të trajtohet me ushqim tre vakte në ditë sipas normave të miratuara për këtë qëllim, si dhe "si dhe të marrë ushqime shtesë nga familja sipas rekomandimeve të mjekut. Çdo nevojë e veçantë dietike do të këshillohet nga mjeku i njësisë policore.
- 1.17 Të dalë në ajrim sipas mundësive dhe kushteve që kanë ambientet e dhomave të sigurisë por jo më pak se dy orë në ditë (për ato ambiente sigurie që nuk plotësojnë kushtet për ajrim e ndriçim të plotë natyral).
- 1.18 Të pushojë (flejë) në krevat të veçantë gjatë orëve të natës, sipas orarit të miratuar nga drejtori/shëfi i komisariatit të policisë, por jo më pak se 8 orë gjumë në 24 - orë.
- 1.19 Të marrë materiale për fjetje si dyshek, batanije, jastëk sipas kushteve klimaterike (në verë një dhe në dimër tre batanije). Për zonat verilindore me urdhër të shefit komisariatit ky numër mund të rritet nga tre në pesë.

- 1.20 Të lexojnë shtypin e ditës, literaturë tjetër artistike, fetare, shkencore, politike e shoqërore e cila sigurohet me shpenzimet e veta.
- 1.21 Të dëgjojnë radio të cilat mund të jenë të instaluara në sistemin e dhomave të sigurisë ose radio individuale të cilat ushqehen me bateri dhe janë me kufje.
- 1.22 Të ushtrojë ritet fetare duke mos prishur rregullin në këto ambiente dhe pa shqetësuar të arrestuarit/ndaluarit e tjerë.
- 1.23 Të kryejë nevojat personale në çdo kohë, si dhe të ketë akses për ujë të pijshëm, për larje e pastrim në mënyrë të vazhdueshme.
- 1.24 Të mbajë letër e laps për të shkruar, si dhe pastë e furçë dhëmbësh, pajisje tualeti, me shpenzimet e veta.
- 1.25 Nëse veshjet tuaja bllokohen për nevoja të hetimit, policia duhet të sigurojë veshje alternative nëpërmjet familjes tuaj dhe në pamundësi nga vetë policia.
- 1.26 Në rastin kur merreni në pyetje nga policia gjyqësore/prokurori, gëzoni këto të drejta :
- a) Ambienti i intervistimit apo marrjes në pyetje duhet të jetë i pastër, me sistem ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial (elektrik).
 - b) Të qëndroni ulur.
 - c) Të kërkonti që punonjësit e policisë gjyqësore apo prokurori të prezantohen para se të kryejnë veprimet procedurale me ju.
 - d) Gjatë procesit të pyetjeve/intervistimit duhet të bëni pushim në çdo dy orë.
 - e) Kur jeni i mitur (14 - 18 vjeç) ose keni probleme në të mësuarit apo probleme shëndetësore mendore, dhe policia do të kryejë veprimet e mëposhtme ju duhet të jeni i shoqëruar nga një person me moshë të përshtatshme (jo punonjës policie), si :
 - i. Kur policia ju deklaron/komunikon të drejtat e tuaja dhe ju tregon arsyet e shkaqet pse po mbaheni në njësinë policore.
 - ii. Në rastet kur ju merreni në pyetje ose ju kërkohet të nënshkruani një deklaratë, procesverbal pyetjeje, dokumente të tjera proceduriale, apo shënime të policisë.
 - iii. Në rastet kur ju kërkohet të hiqni më shumë se rrobat e sipërme për t'ju kontrolluar.
 - iv. Në rastet kur ju kërkohet të kryeni një veprim procedural të identifikimit nga dëshmitarët okularë.
- 1.27 Të marrë nga drejtoria/komisariati policisë sapun, detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës e pastërtisë vetjake e të ambientit ku qëndron, sipas normave e rregullave për këtë qëllim.
- 1.28 Të nënshkruajë një deklaratë për njohjen e të drejtave kushtetuese e ligjore që ka i arrestuari/ndaluarit në këtë fazë si dhe gjatë qëndrimit në ambientet e sigurisë, sipas modelit tip bashkëlidhur dhe pjesë të këtij procedure.
- 1.29 Të kërkojë ndihmë sa herë që ka nevojë nëpërmjet butonit të ziles/sinjalit apo komunikimeve direkte tek personeli i shërbimit.

- 1.30 Të paraqesë ankesa e kërkesa me shkrim, me gojë dhe me zarf të mbyllur tek drejtuesit e komisarariatit, drejtorisë policisë Vendore, Drejtorisë Përgjithshme të Policisë, organin e prokurorisë, Avokatin e Popullit, OJF-ve vendase e të huaja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullat dhe procedurat për evidentimin e ankesave, ruajtjen e fshehtësisë, trajtimin e zgjidhjen e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
- 1.31 Personave që vuajnë dhe kanë probleme me shikimin u lejohet mbajtja e syzeve optike.
- 1.32 Nënata që janë me fëmijë në gji, u krijohen kushte për lejimin dhe vazhdimin e trajtimit të fëmijëve me gji.
- 1.33 Personat e dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, deri në transferimin në IEVP, takohen me pjesëtarë të familjes një herë në pesë ditë, pas lejes së dhënë nga drejtuesi i njësisë policore.

2. Detyrat e të arrestuarve/ndaluarve.

- 2.1 Të mbajë rregull e pastërti në dhomë e paradhomë dhe të ruajë higjienën personale.
- 2.2 Të ruajnë e mos dëmtojnë orenditë dhe pajisjet që janë në ambientin e qëndrimit e paradhomë, në rast dëmtimi të kryhen veprimet për dëmshpërblimin sipas rregullave për këtë qëllim.
- 2.3 Të zbatojnë kërkesat e urdhrat e personelit policor të shërbimit në funksion të zbatimit të kërkesave të kësaj procedure.
- 2.4 Të zbatojnë rregullat e brendshme të vendosura në këtë rregullore dhe sipas programit e orarit ditor të veprimeve.
- 2.5 Të krijojnë marrëdhënie e raporte normale me të ndaluarit apo arrestuarit e tjerë (kur në dhomë janë më shumë se një person).
- 2.6 Ti nënshtrohen kontrollit personal dhe të ambientit të qëndrimit nga autoritetet policore, sa herë që shikohet e nevojshme. Për të ndaluarat e arrestuarat femra një kontroll i tillë kryhet nga punonjëse policie femra me praninë e punonjësve të tjerë të policisë.
- 2.7 Të mos mbajë me vete në dhomë sende e mjete të tjera të ndaluara që përbëjnë rrezik për kushtet e sigurisë, për jetën e shëndetin e të ndaluarve e arrestuarve e personelin policor, me përjashtim të atyre të lejuara sipas kësaj procedure.
- 2.8 Të mos konsumojë produkte të duhanit në ambientet/mjediset e mbyllura të sistemit të dhomave të sigurisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 "*Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit*", i ndryshuar.

VII. RREGULLAT PËR TRAJTIMIN DHE KUSHTET E JETESËS NË DHOMAT E SIGURISË

1. Orari i veprimeve dhe koha e pushimit.

- 1.1 Për të arrestuarit/ndaluarit zbatohet një orar veprimesh ditore i cili miratohet nga drejtuesi i drejtorisë/komisariatit të policisë, nëpërmjet të cilit përcaktohet orari i zgjimit, pastrimit, ngrënies së ushqimit, ajrimit, argëtimit, dhe fjetjes.
- 1.2 Të arrestuarit dhe ndaluarit pushojnë/flenë jo më pak se 8 orë gjatë 24 - orëve.
- 1.3 Për rastet kur nuk kanë me vete apo veshur veshjet e duhura sipas stinës, u lejohet futja e veshjeve shtesë nga familjarët, pasi të jenë kontrolluar më parë nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.
- 1.4 Gjatë kohës së fjetjes të arrestuarve/ndaluarve u sigurohet qetësia e duhur dhe ndriçimi i përshtatshëm për realizimin e tij.
- 1.5 Ndalohet nxjerrja e të arrestuarit/ndaluarit nga dhoma e sigurisë për të kryer takime me avokatin mbrojtës, veprime hetimore procedurale (marrja në pyetje, paraqitje për njohje etj) gjatë natës/kohës së pushimit nga ora 22.00 - 06.00.

2. Trajtimi ushqimor.

- 2.1 Të arrestuarit/ndaluarit përfitojnë trajtim ushqimor gjatë ditës (gjatë 24 orëve) me tre vakte, i cili u jepet në këto orare :
 - a) Mëngjesi nga ora 07 - 07.30.
 - b) Dreka nga ora 13.00 - 13.30.
 - c) Darka nga ora 19.00 - 19.30.
- 2.2 Trajtimi me ushqim i të arrestuarve/ndaluarve bëhet sipas normave të përcaktuara e miratuara me akt të përbashkët të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë.
- 2.3 Trajtimi me ushqim i të arrestuarit/ndaluarit fillon jo më vonë se 6 orë pas futjes/akomodimit në ambientet e dhomave të sigurisë.
- 2.4 Përgatitja dhe gatimi i ushqimit bëhet në ambiente të posaçme (kuzhina) të drejtorive/komisariateve të policisë ose në ambientet e subjekteve private të kontraktuara për ofrimin e këtij shërbimi.
- 2.5 Për çdo vakt merren kampionë nga ushqimi i gatuar konsumuar nga të ndaluarit/arrestuarit, duke u mbajtur në kushte frigoriferike dhe të vulosura për 24 orë nga personeli i kuzhinës së drejtorisë/komisariatit ose subjektit privat që është kontraktuar për të ofruar këtë shërbim.
- 2.6 Ushqimi shërbehet i freskët në mënyrë individuale në dhomë me pjata, lugë e pirun plastikë.
- 2.7 Ndalohet mbajtja e ushqimeve në ambientet e qëndrimit apo paradhomën e dhomave të sigurisë.

3. Pastrimi dhe higjiena.

- 3.1 Të ndaluarit/arrestuarit si rregull për nevoja të pastrimit dhe të higjienës personale nxirren nga dhoma e qëndrimit në paradhomë në mëngjes, drekë e darkë gjatë kohës kur konsumojnë vaktet e ushqimit, si dhe në çdo rast që është e nevojshme.

- 3.2 Dalja nga dhoma për të shkuar në paradhomë bëhet duke zbatuar masat e sigurisë. Gjatë kësaj kohe dera e hyrjes për në paradhomë mbahet e mbyllur.
- 3.3 Pastrimi/rruajtja e të ndaluarve dhe arrestuarve bëhet me mjete të siguruar nga ai vetë të cilat mbahen në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Këto mjete jepen e merren sa herë që i arrestuari/ndaluar kryhen një pastrim të tillë.
- 3.4 Për efekt të sigurimit e ruajtjes së higjienës e pastërtisë në këtë ambient, disa herë në ditë kryhet pastrimi dhe një herë në ditë klorifikimi i pajisjeve të VC-ve.
- 3.5 Kontrolli i masave dhe të gjendjes higjieno- sanitare në dhomat e sigurisë, kryhet në mënyrë periodike nga mjeku apo ndihmës mjeku i drejtorisë apo komisarariatit të policisë, mjekë të qendrave spitalore si dhe drejtuesit e njësive policore.
- 3.6 Teshat që u jepen për fjetje personave të arrestuar/ndaluar (batanije, jastëkë) ndërrohen dhe lahen në mënyrë periodike dhe sa herë që është e nevojshme për ruajtjen e higjienës dhe pastërtisë.
- 3.7 Me qëllim parandalimin e infektimit, përhapjes së sëmundjeve dhe garantimin e shëndetit të personelit policor dhe personelit tjetër që kryen shërbime në ambientet e dhomave të sigurisë si dhe personave që janë në kontakt me sendet e materialet që kanë qenë në përdorim nga këta persona, duhet të jenë të pajisur dhe përdorin veshje e mjete të posaçme mbrojtëse si :
 - a) Doreza plastike.
 - b) Maska mbrojtëse.
 - c) Përparëse.
 - d) Kapele e syze mbrojtëse.
 - e) Mjete dhe pajisje të tjera të rekomanduara nga mjeku.

4. Shërbimi shëndetësor.

- 4.1 Pranë drejtorive të policisë së qarqeve ngrihet dhe funksionon shërbimi shëndetësor, me personel mjekë apo ndihmës mjekë.
- 4.2 Vizitat mjekësore ndaj të arrestuarve/ndaluarve kryhen nga mjeku apo ndihmës mjekë të njësive policore, dhe në mungesë të tyre nga mjekë të qendrave spitalore rajonale të miratuar nga shefi komisarariatit policisë.
- 4.3 Për çdo vizitë/kontroll mjekësor të kryer personeli mjekësor çel dhe plotëson kartelën/dosjen personale mjekësore për të arrestuarin/ndaluarin. Për të arrestuarit e ndaluarit ndaj të cilëve gjykata ka caktuar si masë sigurimi “arrest në burg” kartela plotësohet në dy kopje, një prej të cilave shoqëron personin në IEVP.
- 4.4 Një kopje e kartelave mjekësore mbahet e ruhet nga mjeku në rafte/kasaforta në dhomën e vizitave mjekësore, sipas afateve kohore të miratuara për këtë qëllim.
- 4.5 Vizitat kryhen në një dhomë të caktuar për këtë qëllim brenda sistemit të dhomave të sigurisë, pa prezencën dhe vështrimin e personelit policor apo personave të tjerë, me përjashtim të rasteve kur mjeku kërkon të kundërtën.

- 4.6 Të dhënat e pasqyruara në kartelat mjekësore janë të pa aksesueshme ndaj stafit jo - mjekësor, me përjashtim të rasteve kur kërkohen nga organet e prokurorisë dhe të gjykatës gjatë një procesi hetimor dhe gjyqësor.
- 4.7 Medikamentet për trajtimin e rasteve të urgjencave për të arrestuarit/ndaluarit sigurohen nga drejtoria/komisariati i policisë, sipas fondeve financiare të akorduara e detajuara për këtë qëllim. Me miratim dhe rekomandim të mjekut i arrestuari/ndaluari mund të përdorë dhe medikamente të siguruara nga familja.
- 4.8 Në rast se gjatë vizitës/kontrollit konstatohen dëmtime fizike, plagë apo gjakrrjedhje, etj mjeku/ndihmës mjeku i njësisë policore dhe specialisti i shërbimeve të rendit marrin masa të menjëhershme për dërgimin e tij në qendrën më të afërt spitalore për ti dhënë ndihmën e nevojshme
- 4.9 Nëse një i ndaluar apo arrestuar vuan nga sëmundje kronike dhe për këtë është nën trajtimin e medikamenteve, merren masa për mos ndërprerjen e trajtimit. Dhënia e medikamenteve bëhet sipas këshillave të mjekut specialist apo mjekut të njësisë policore.
- 4.10 Personeli policor i ngarkuar me ruajtjen, sigurimin dhe trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve për çdo ankesë, kërkesë për ndihmë e shqetësime shëndetësore të marra nga të ndaluarit/arrestuar, njofton menjëherë shërbimin e Sallës Komandimit dhe eprorin e drejtpërdrejtë dhe këta të fundit njoftojnë mjekun/ndihmësmjekun e njësisë policore.
- 4.11 Në varësi të gjendjes së personit të ndaluar/arrestuar dhe në pamundësinë e ardhjes në mënyrë të menjëhershme të mjekut/ndihmësmjekut të njësisë policore, i ndaluari/arrestuari dërgohet në qendrën spitalore më të afërt për të marrë ndihmën e duhur. Në këtë rast personeli mjekësor i qendrës mjekësore/spitalore bëjnë shënimet përkatëse në librin e vizitave mjekësore.
- 4.12 Kur një i ndaluar/arrestuar ka shenja të një sëmundje ngjitëse merren këto masa :
- a) Personi mbahet i izoluar në dhomë i ndarë nga personat e tjerë,
 - b) Sendet personale të tij mbahen më vete dhe të ambalazuara qese të veçanta plastike.
 - c) Merren masa për dërgimin e tij në qendrat e specializuara spitalore për këtë sëmundje.
 - d) Dezinfectimin e ambientit ku ka qëndruar i sëmurë si dhe i sendeve që janë përdorur prej tij.
 - e) Përcaktohen masat profilaktike e mjekësore që duhet të merren ndaj personelit të shërbimit që kanë qenë në kontakt me të sëmurin, etj.
- 4.13 Personeli policor dhe stafi mjekësor duhet të vlerësojnë çdo pretendim apo ankesë të ndaluarve/arrestuarve për shqetësime shëndetësore duke marrë masa për vërtetimin e vërtetësisë ose jo të pretendimeve.
- 4.14 Për të ndaluarit/arrestuarit që janë në trajtim mjekësor, personeli mjekësor jep me shkrim rekomandimet dhe këshillat për përdorimin e barnave duke i pasqyruar në kartelën/dosjen mjekësore të ndaluarit/arrestuarit. Kopje me shkrim të rekomandimeve për përdorimin e medikamenteve i jepen dhe

përgjegjësit të dhomave të sigurisë i cili ndjek zbatimin e tyre si dhe i administron në fashikullin/dosjen e të arrestuarit/ndaluarit.

- 4.15 Kur konstatohen shenja apo ka ankesa për përdorim dhune merren këto masa:
- Hartohet procesverbali i verifikimit paraprak sipas përcaktimeve të bëra në germën "a" dhe "e" të pikës 7 të Kreut të V të procedurës, ku pasqyrohen dëmtimet dhe pretendimet e të arrestuarit/ndaluarit.
 - Njoftohet menjëherë shefi i komisariatit të policisë/drejtori i policisë së Vendore të cilët vlerësojnë dhe marrin masa për trajtimin ligjor të rastit për personat përgjegjës si ato disiplinore/administrative dhe penale.
 - Vënë në dijeni organin e prokurorisë së rrethit gjyqësor për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore .
 - Vënë në dispozicion të organit të prokurorisë kopje të procesverbalit të verifikimit paraprak.

5. Rregullat e sigurisë gjatë marrjes në pyetje/intervistim dhe takimeve të ndryshme me të arrestuarin/ndaluarin

5.1 Nxjerrja e të ndaluarit e arrestuarit nga dhoma e qëndrimit për në dhomën e intervistimit/marrjes në pyetje bëhet kur :

- Kërkohet të kryhen veprime procedurale hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore/prokurori që ndjek çështjen.
- Kur kërkohet të takohet nga avokati mbrojtës i zgjedhur nga i arrestuari/ndaluari apo i caktuar nga prokurori. Avokati mbrojtës ka të drejtë të marrë takim me klientin e tij në çdo kohë dhe sa herë që e sheh të arsyeshme.
- Kur kërkohet të merret takim nga përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit. Ky takim zhvillohet pa prezencën e punonjësve të policisë, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga këta përfaqësues.
- Kur përfaqësues të OJF-ve e OJQ-ve të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kryejnë inspektime e vizita, verifikime apo takime me të ndaluar e arrestuar të veçantë.
- Kur përfaqësues të trupit diplomatik (të akredituar në vendin tonë) të shtetit përkatës kryejnë takime me nënshtetasit e tyre apo shtetas të tjerë që kanë marrë përsipër mbrojtjen e tyre.

5.2 Veprimet për nxjerrjen, shoqërimin e sigurimin e të arrestuarit/ndaluarit për në dhomën për këtë qëllim, kryhen nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë apo zëvendësi i tij së bashku me një punonjës tjetër policie.

5.3 Lëvizja e të arrestuarit/ndaluarit nga dhoma e qëndrimit për në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimit bëhet me pranga në duar, si dhe anasjelltas.

5.4 Gjatë kohës së zhvillimit të procesit të pyetjeve, takimeve apo veprime të tjera procedurale, të arrestuarit/ndaluarit i hiqen prangat nga duart.

5.5 Ndalohet marrja në pyetje apo kryerja e veprimeve të tjera procedurale me të arrestuarit/ndaluarit që kanë kërkuar mbrojtje me avokat pa qenë i pranishëm ky i fundit

- 5.6 Gjatë marrjes në pyetje në dhomën e hetimit nga oficerët e policisë gjyqësore, zhvillimit të takimit me avokatin mbrojtës apo kujdestarin ligjor, garantohet konfidencialiteti i bisedave të tyre. Punonjësi i policisë qëndron jashtë dhomës së intervistimit, pranë derës nga ana e jashtme e saj, i gatshëm për të ndërhyrë në rast të kërkimit të ndihmës nga oficeri i policisë gjyqësore, prokurori apo avokati. Qëndrimi të jetë në një distancë të tillë që të mos dëgjohen bisedat që zhvillohen nga brenda.
- 5.7 Të gjitha takimet e veprimet që kryhen me të arrestuarin/ndaluarin nga avokati, prokurori, oficeri i policisë gjyqësore apo persona të tjerë të autorizuar, dokumentohen në librat e regjistrat përkatës.

6. Rregullat për realizimin e ajrimit të arrestuarve/ndaluarve.

- 6.1 Ajrimi i të arrestuarve/ndaluarve do të kryhet si alternativë, për rastet kur mungojnë kushtet dhe hapësirat e nevojshme sipas standardeve të përcaktuara në këtë procedure.
- 6.2 Ajrimi kryhet në mjedise të caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të Sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit).
- 6.3 Nxjerrja në ajrim bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë apo zëvendësi i tij në prezencën e një punonjësi tjetër policie (jo punonjësi i shërbimit të brendshëm).
- 6.4 Ajrimi kryhet duke nxjerrë të arrestuarit/ndaluarit e një dhome bashkërisht dhe pas përfundimit të ajrimit e futjes së tyre në dhomën e sigurisë veprohet me dhomat e tjera. Koha e qëndrimit në ajrim është jo më pak se dy orë në ditë.
- 6.5 Në rastet kur gjatë ajrimit konstatohen shkelje të rregullave, punonjësit e policisë urdhërojnë ndërprerjen e ajrimit dhe të arrestuarit/ndaluarit futen në dhoma. Punonjësit e policisë përpilojnë raport shërbimi dhe informojnë eprorin dhe titullarin e drejtorisë/komisariatit të policisë dhe prokurorinë.

7. Ushqyerja e fëmijëve që janë në gji, nga nënat e tyre që gjendet në ndaluarar/arrestuara.

- 7.1 Ushqyerja me gji e fëmijëve nga nënat e tyre, realizohet në dhomat e vizitave të mjekut ose ambientin e punës të punonjësit të policisë të funksionit : Ndhmës Specialistit Përgjegjës i Dhomave të Sigurisë, brenda sistemit të dhomave të sigurisë.
- 7.2 Kërkesa për ushqyerjen e fëmijës që është në gji, bëhet nga nëna e fëmijës (arrestuara/ndaluar) dhe familjarët apo të afërmit e saj.
- 7.3 Familjarët/të afërmit duhet të paraqesin certifikatën e lindjes së fëmijës me qëllim vërtetimin e identitetit dhe mëmësisë të fëmijës. Një kopje e certifikatës administrohet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.
- 7.4 Kërkesa e paraqitur nga e arrestuara/ndaluar për vazhdimin e ushqyerjes së fëmijës i transmetohet menjëherë eprorit të punonjësit të policisë dhe drejtuesve të njësisë policore.
- 7.5 Drejtuesit e njësisë policore nëpërmjet: ndihmës specialistëve - SPZ apo specialistëve për krimet, realizojnë njoftimin e familjes apo të afërme për të sjellë fëmijën në komisariatit të policisë, sa më shpejt që është mundur.

- 7.6 Kur ushqyerja e fëmijës kërkohet nga familjarët/të afërmit, vihet në dijeni nëna e fëmijës për kërkesën e bërë. Nëse e arrestuara/ndaluara refuzon të kryejë ushqyerjen e fëmijës, mbahet procesverbal dhe njoftohet menjëherë prokurori i çështjes dhe kryhen veprimet përkatëse procedurale.
- 7.7 Familjarët apo të afërmit që sjellin fëmijën deri në përfundimin e ushqyerjes së fëmijës, presin jashtë ambienteve të dhomave të sigurisë.
- 7.8 Gjatë realizimit të ushqyerjes të fëmijës nga nëna, është i pranishëm një punonjës policie femër e cila qëndron në të njëjtin ambient me nënën dhe fëmijën dhe në korridor pranë derës së këtij ambienti qëndron përgjegjësi i dhomave të sigurisë apo një punonjës policie tjetër.
- 7.9 Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kryen evidentimin e të dhënave lidhur me realizimin e ushqyerjes së fëmijës nga nëna, duke pasqyruar të dhëna për të arrestuarën/ndaluarën, fëmijën, personat e familjes që sjellin fëmijën, data dhe ora e kryerjes së ushqyerjes.

VIII. NORMAT E PARAMETRAT E NDËRTIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DHOMAVE TË SIGURISË

1. Ndërtimi i dhomave të sigurisë në njësitë policore.

- 1.1 Si rregull dhomat e sigurisë ndërtohen dhe funksionojnë në komisariatet e policisë në territorin e të cilave janë ngritur dhe funksionojnë organet e drejtësisë si gjykatat e rretheve gjyqësore dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.
- 1.2 Mbajtja, sigurimi dhe trajtimi i personave të arrestuar/ndaluar bëhet në ambientet e dhomave të sigurisë, sipas ndarjeve :
- a) Personat që arrestohen/ndalohen nga shërbimi i policisë gjyqësore të komisariateve të policisë që nuk janë rrethe gjyqësore mbahen e sigurohen në ambientet e dhomave të sigurisë të komisariatit të policisë që është rreth gjyqësor ose komisariatit të policisë pranë Drejtorisë vendore të policisë.
 - b) Të arrestuarit/ndaluarit e komisariateve të policisë që janë rrethe gjyqësore por nuk kanë në funksionim ambiente të dhomave të sigurisë, mbahen e trajtohen në dhomat e sigurisë të komisariateve të policisë pranë drejtorive të policisë së qarqeve (komisariatet e qendrës).
 - c) Në rastet kur në komisariatet e policisë pranë drejtorive vendore të policisë nuk funksionojnë dhomat e sigurisë, sigurimi dhe trajtimi i tyre bëhet në dhomat e sigurisë të komisariateve të tjera brenda drejtorisë vendore të policisë ose në komisariatet e policisë të drejtorive vendore të policisë të tjera, sipas urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit.
- 1.3 Ndërtimi dhe funksionimi i tyre bëhet sipas normave, parametrave dhe standardeve të vendeve të BE-së, përcaktimeve të bëra në Konventën e "Për parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e degraduese" dhe përcaktimeve të bëra në këtë Procedure.

1.4 Projektet për ndërtimin apo restaurimin e dhomave të sigurisë përgatiten nga strukturat përkatëse të Drejtorisë të Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse në bashkëpunim dhe strukturat e Drejtorisë së përgjithshme për sigurinë Publike dhe drejtuesit e drejtorive/komisariateve vendore të policisë për përcaktimin dhe zgjidhjen e nevojave që kanë për këtë qëllim.

2. Kushtet që duhet të plotësojnë ambientet e dhomave të sigurisë.

2.1 Dhomat e sigurisë duhet të sigurojnë kushte për :

- a. Qëndrim dhe jetesë normale.
- b. Ajrim dhe ndriçim të plotë natyral dhe për të lejuar shikim e lexim.
- c. Kryerje të nevojave personale në çdo kohë.
- d. Sigurimin e jetës dhe të shëndetit të tyre nga veprimet e kundërligjshme të personave të tretë, si dhe për të parandaluar largimin apo arratisjet me forcë nga këto ambiente.
- e. Komunikim të shpejtë me personelin e shërbimit kur kanë nevojë për ndihmë.
- f. Kushte për realizimin e takimeve me avokatin apo përfaqësues të organizmave kombëtare e ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.
- g. Akses për ujë të rrjedhshëm për larje dhe pirje, në çdo kohë.
- h. Siguri për personelin që shërben dhe lehtësi të tyre për mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e të arrestuarve/ndaluarve.
- i. Parandalimin e kontakteve/komunikimeve të pakontrolluara jashtë dhomave.
- j. Kryerjen e inspektimeve, takimeve dhe vizitave mjekësore.
- k. Kontrollin, monitorimin dhe regjistrimin me anë të pajisjeve të regjistrimit audio - vizive të veprimeve të punonjësve të policisë që kryhen me të arrestuarit/ndaluarit, marrjen në pyetje nga përfaqësuesit e organit të akuzës, si dhe çdo aktivitet tjetër në këto ambiente.

2.1 Në çdo rast para vënies në përdorim/funksion apo kur ambientet e dhomave të sigurisë i nënshtrohen rikonstruktimit të plotë, drejtoria vendore e policisë dërgon informacion me shkrim në Drejtorinë e Policisë së Shtetit për përfundimin e punimeve, plotësimin e normave dhe të standardeve të jetesës e sigurisë.

2.2 Për verifikimin e vlerësimin në vend të kushteve të sigurisë dhe ato të jetesës në përputhje me përcaktimet, normat e standardet e përcaktuara në këtë procedurë, me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit, ngrihet një grupe pune me specialistë të strukturave qendrore të rendit & sigurisë publike dhe të strukturave për shërbimet mbështetëse.

2.3 Në varësi të realizimit të këtyre kushteve grupi i punës përgatit urdhrin e Drejtorit të Policisë së Shtetit për miratimin e vënies në funksionim dhe fillimit të aktivitetit në këto ambiente për mbajtjen e trajtimit e personave të ndaluar/arrestuar.

Në rast se konstatohet që nuk janë përmbushur kërkesat dhe normat e përcaktuara në këtë procedurë, grupi i punës informon Drejtorin e Policisë së Shtetit dhe përcakton masat/detyrat që duhet të kryhen nga strukturat vendore

të policisë dhe subjekti realizues i punimeve - për përmbushjen e parametrave dhe standardeve të përcaktuara në detyrën e projektimit.

3. Kriteret për ndërtimin e dhomave të sigurisë.

3.1 Dhomat e sigurisë për qëndrimin dhe mbajtjen e të arrestuarve/ndaluarve janë të ndara dhe mundësisht me kapacitet për mbajtjen e trajtimin e një personi. Në pamundësi të kësaj, ato ndërtohen me përmasa e hapësira të mjaftueshme për dy deri në tre persona.

3.2 Muret, tavani, zgara e hekurit, dyert, dritaret, dyshemeja dhe orenditë e pajisjet e tjera në sistemin e dhomave të sigurisë të jenë ndërtohen dhe vendosen sipas këtyre parametrave teknikë :

a) Muret të kenë një trashësi 35 cm, prej materiali të fortë (beton ose tullë e plotë), sipërfaqet e mureve të jenë të suvatuara e të lyera, të mos komunikojnë direkt me mjedisin e destinuar për publikun por të ketë një rrethim teli në distancë jo më pak se 5 metër nga to.

b) Dyshemeja të jetë prej materiali të fortë betoni të derdhur me trashësi jo më pak se 20 cm e përbërë me zgarë hekuri, me sipërfaqe të tillë që të krijojë lehtësi pastrimi e ruajtjen e higjienës (beton i lëmuar, pllakë).

c) Nën dysheme vendosen të gjitha kabllot e tubat e instalimeve të ngrohjes, ato hidraulike dhe ato elektrike, të cilat të jenë të fshehura e të mbuluar me beton. Në rast se nuk është e mundur ngrohja nga dyshemeja, pajisjet për ngrohje të vendosen në paradhomë.

d) Zgara e hekurit që ndan dhomën nga paradhoma është prej shufrash apo profile çeliku me seksion jo më pak se 25 milimetër, të vendosura vetëm në pozicionin vertikal dhe të fiksuara në dysheme dhe tavan, të pa lëvizshme e të pa çmontueshme nga përdorimi i forcës së duarve e krahëve dhe me një distancë nga njëra tjetra jo me shume se 12 cm.

Në rastet kur lartësia e ambientit është më shumë se 2.5 m për të përforcuar e rritur sigurinë e elementëve të zgarëz së hekurit ndarëse vendosen:

d.1 Një shufër metalike në pozicion horizontal në një lartësi jo më shumë se 60 cm, ose ndërtohet një mur nga dyshemeja me një lartësi 50 cm, në të cilin të jenë të fiksuara të gjitha shufrat metalike vertikale.

e) Tavani i dhomave në ambientet e sigurisë të jetë i ndërtuar sipas kushteve teknike të përcaktuara për dyshemenë. Të jetë i suvatur dhe të mos ketë të instaluar asnjë tubacion apo kablo që të jenë të dukshme apo të varura.

3.3 Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë : sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m.

3.4 Sistemi i dhomave të sigurisë përveç rrejtimit të furnizimit me energji elektrike, duhet të ketë një burim rezervë të energjisë në rast të ndërprerjes së saj. Burimi rezervë duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të vënë në përdorim pajisjet elektrike dhe ndriçuar ambientin.

4. Rregullat për ndërtimin e funksionimin e ambientit të qëndrimit, në dhomën e sigurisë.

- 4.1 Ambienti i qëndrimit brenda dhomës së sigurisë për të arrestuarit/ndaluarit është brenda parametrave të përcaktuara në pikën "3.3" të pikës 3, në Kreun e VIII - të.
- 4.2 Kushtet teknike të ndërtimit e të sigurisë për muret, tavanet dhe dyshemet janë sipas përcaktimeve në pikën "3.2" të pikës 3, në Kreun e VIII - të.
- 4.3 Në ambientin e qëndrimit vendosen pajisjet dhe orenditë si me poshtë:
- a) Krevati i ndërtuar me elementë të fortë druri apo hekuri, cili është i fiksuar me mentesha e vida në dysheme, i palëvizshëm dhe i pa çmontueshëm pa përdorur pajisje të veçanta.
 - b) Pisja e VC-së pa mbajtëse (ndenjëse integrale), e fiksuar në mënyrë të pa çmontueshme dhe pa depozitën e ujit. Kjo e fundit vendoset në paradhomë dhe komandohet me levë, buton apo çelës nga i ndaluarit apo arrestuari që nga dhoma e tij.
Pozicionimi i pajisjes së VC-së të jetë në pozicion që të mos pengojë pamjen/vëzhgimin e punonjësit të policisë nga sporteli i derës së paradhomës.
Pajisja e VC-së është e rrethuar me një mur betoni apo tulle të suvatuar në një lartësi 1m nga sipërfaqja e dyshemesë dhe nuk ka derë.
 - c) Buton zileje/sinjali i montuar në mur për kontakt me punonjësën e shërbimit në rast nevojë. Kjo zile të dëgjohet nga punonjësi i policisë i ngarkuar për mbajtjen në kontroll të arrestuarit/ndaluarit. Butoni i ziles së kontaktit të jetë i ngarkuar në maksimum me energji jo më shumë se 24 - Volt.
 - d) Në dhomën e qëndrimit nuk do të ketë të instaluar pajisje ndriçimi dhe asnjë instalim tjetër elektrik, hidraulik apo ngrohje, tubo apo hekura të dala jashtë murit apo dyshemesë, të cilat cenojnë elementët e sigurisë për personat e arrestuar/ndaluar. Ndriçimi i dhomës do të bëhet nëpërmjet pajisjeve elektrike të vendosur në paradhomë.
- 4.4 Montimi i krevateve bëhet në pozicion të përshtatshëm me qëllim që të vëzhgohet/shikohet lehtësisht nga punonjësi i policisë nëpërmjet sportelit të derës së paradhomës.
- 4.5 Dera që lidh paradhomën me ambientin e qëndrimit, të jetë ndërtuar si më poshtë:
- a) Me gjerësi 90-100 cm dhe lartësi sa lartësia e dhomës, e montuar në zgarën e hekurit që ndan dhomën e qëndrimit me paradhomën, me kornizë (profile hekuri) të puthitur me pjesën e tavanit, të mos ketë mentesha por aksi i fundit i derës të jetë futur thellë në dysheme dhe tavan.
 - b) Të jetë ndërtuar prej shufrash vertikale çeliku sipas përcaktimeve të bëra në pikën "3.2" të pikës 3, në Kreun e VIII- të.
 - c) Dera të jetë me hapje nga ana e brendshme e dhomës dhe të mos ketë dorezë.
 - d) Të jetë e pajisur me bravë të rëndë (të forte, e aftë të përballojë akte vandale) e cila të plotësojë kërkesat e bravave të sigurta dhe të mos jetë e montuar më

shume se 1.3 m në lartësi nga dyshemeja. Brava të jetë e fshehur në profilin anësor të derës, nga i cili të duket vetëm fisheku i saj.

e) Mbyllja e kësaj dere të behet vetëm nga jashtë (nga paradhoma).

5. Rregullat për ndërtimin dhe funksionimin e paradhomës.

Paradhoma është pjesë përbërëse e dhomës së sigurisë dhe shtojcë e ambientit të qëndrimit.

5.1 Kushtet teknike të ndërtimit e të sigurisë për muret, tavanet dhe dyshemenë janë sipas përcaktimeve në germat "a", "b", "c" dhe "e" të pikës "3.2", pika 3 në Kreun e VIII- të.

5.2 Në ambientin e paradhomës vendosen dhe instalohen pajisjet e mëposhtme:

- a) Pajisje për tu larë (lavaman së bashku me rubinetin e komandimit të ujit) të cilat të mos thyhen e çmontohen lehtë.
- b) Mbajtëse uji (depozitë uji) për VC-në.
- c) Pajisje elektrike për ndriçim të përshtatshëm të paradhomës e dhomës së qëndrimit, e cila vendoset në tavan, e mbrojtur nga një rrjetë teli për të mos lejuar prekjen me dorë.
- d) Pajisje apo sisteme për ngrohje gjate dimrit (kur nuk realizohet ngrohja nga poshtë dyshemesë). Pajisjet e ngrohjes duhet të sigurojnë në stinën e dimrit një temperaturë nga 18 – 29 gradë Celsius. Termostatet e këtyre pajisjeve të vendosen jashtë ambientit të qëndrimit e paradhomës.
- e) Pasqyrë me përbërje çeliku e paoksidueshme, e pa thyeshme me përmasa 50 x 40 cm, e vendosur në lartësi të përshtatshme për realizimin e funksionit të saj. Kjo pasqyrë inkasohet në mur sipas këtij specifikimi teknik: sipërfaqja e pasme e pasqyrës lyhet me silikon të zi (silikoni të jetë me përbërje gome), sipërfaqja e pasqyrës të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqen e murit.
- f) Të gjitha pajisjet e mësipërme të jenë të vendosura në një largësi të tillë nga zgara e hekurit që ndan ambientin e qëndrimit me paradhomën për të mos lejuar prekjen me dorë nga i ndaluar apo arrestuari që nga dhoma.

5.3 Dera kryesore e hyrjes për në paradhomë të jetë prej materiali të fortë (elementë druri ose çeliku) dhe nga ana e jashtme të jetë me veshje fibre apo shtresë druri, nga ana e brendshme e saj të jetë e veshur me llamarinë duke fshehur tehet prerës të saj. Gjerësia e saj të jetë jo më pak se 90 cm e gjatësi 2 metër. Dera fiksohet në mur në mënyrë të atillë që pa pajisje të veçanta të mos hiqet e çmontohet. Hapja e kësaj dere të jetë nga brenda paradhomës, dhe mbyllja të bëhet vetëm nga jashtë me bravë sekrete.

5.4 Në derë, në qendër të saj dhe në lartësi 1.4 metër nga dyshemeja të ketë një dritare me përmasa 40 cm x 40 cm e cila të jetë e bllokuar nga një zgarë hekuri me katrorë 5 x 5cm, shufrat e të cilës janë me diametër 6 mm. Kjo zgarë të lejojë kryerjen e vëzhgimit dhe kontrollit ndaj të arrestuarit/ndaluarit nga personeli policor dhe mos lejojë futjen e duarve.

- 5.5 Si rregull në paradhomë vendoset edhe dritarja për ndriçim dhe ajrim të plotë natyral të dhomës së sigurisë. Në pamundësi të vendosjes së saj në paradhomë vendoset dhe në ambientin e qëndrimit. Kjo dritare nga ana e brendshme të jetë e siguruar me rrjetë teli të imët me seksion 6 mm e kuadrate jo më shume se 2 x 2 cm, më pas të ketë zgarë me elementë hekuri me trashësi 16-18 mm me kuadrate 15x15 cm. Nga ana e jashtme ka rrjetë të imët për ndalimin e hyrjes së insekteve si dhe më pas dritare me kanate të pajisura me xham me hapje nga jashtë.
- 5.6 Në rast të pamundësisë të hapjes së kanateve të dritares duhet të sigurohen kushte për ajrim e ventilim (300 cm katror), të cilat të mundësojnë sjelljen e një sasive të mjaftueshme ajri për pastrimin e ajrit të ndotur dhe të erërave të këqija që mund të krijohen. Daljet e tubave të ajrimit në dhomat e sigurisë, duhet të fiksohen në mur apo dysheme.

6. Rregullat për ndërtimin e korridorit të dhomave të sigurisë.

- 6.1 Korridori i brendshëm i dhomave të sigurisë të jetë me përmasa e parametrat si më poshtë :
- a) Gjerësi jo më pak se 1.5 metër.
 - b) Në tavan të jenë të fiksuar pajisjet për ndriçimin elektrik të siguruar me rrjetë teli-hekuri, për të hequr mundësinë e kapjes me dorë nga të ndaluarit dhe arrestuarit gjatë hyrjes e daljes në këto ambiente.
 - c) Në korridor, në murin e dhomës të jetë vendosur për çdo dhomë çelës për komandimin e energjisë elektrike për ndriçimin e paradhomave e dhomave si dhe komandimin e bolierit të ambientit të dushit. Çelësat e komandimit të ndriçimit të paradhomave dhe ambienteve të qëndrimit të jetë me reostat për të ulur sasinë e ndriçimit gjatë natës për fjetje e krijuar mundësi ndriçimi për vrojtim e kontroll nga punonjësi i policisë.
 - d) Në një vend të caktuar në murin e korridorit të jenë të vendosur valvul apo rubinet për hapjen e mbylljen e ujit, të veçanta për çdo dhomë.
 - e) Hyrja për në korridorin e ambienteve të dhomave të sigurisë të jetë me dy dyer, një nga ana e jashtme me zgarë hekuri dhe tjetra e brendshme prej dërrase. Dera me zgarë hekuri të jetë prej shufrash hekuri me diametër 16-18 mm me kuadrate me përmasa 15 x 15 cm, me hapje nga jashtë dhe e siguruar me dy dryna. Dera e dërrasës të jete e forte dhe me hapje nga brenda dhe kjo e mbyllur me brave sekrete.
 - f) Në korridor në një vend të caktuar të ketë të vendosur buton zileje alarmi dhe aparat telefonik fiks që përdoret nga punonjësi i shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të arrestuarit/ndaluarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje.
 - g) Në korridor në një kasetë të posaçme vendosen pajisje ku të dëgjohet zilja/sinjali kur kërkohet ndihmë nga i arrestuari/ndaluari, si dhe pajisje për të identifikuar numrin e dhomës nga vjen sinjali për ndihmë.

- h) Në vendin ku është montuar aparati telefonik të vendoset një mini – tavolinë e cila të jetë e fiksuar në mur dhe dysheme. Në këtë tavolinë do të mbahen libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit dhe libri i kontrolleve në këto ambiente.
- i) Për parandalimin e fikjen e zjarreve të mundshme në këto ambiente, në korridor ndërtohet një kënd i posaçëm ku të ketë hidrant për ujë, fiksa të ndryshëm dore, etj të cilat përdoren nga personeli i shërbimit kur është e nevojshme. Këto mjete mbahen të mbyllura me dryn, çelësi i të cilës mbahet nga punonjësi i shërbimit të brendshëm. Në këndin e posaçëm të mbrojtjes nga zjarri ndalohet vendosja e xhamave.

7. Kriteret e sigurisë për dhomat e marrjes në pyetje/intervistimit

- 7.1 Brenda sistemit të dhomave të sigurisë funksionon një dhomë e veçantë për zhvillimin e procesit të marrjes në pyetje, veprime të tjera procedurale, takime, vizita të ndryshme me të arrestuarit/ndaluarit, etj, e cila është me përmasa jo më pak se 4m x 4m dhe lartësi jo më pak se 2.5 ml.
- 7.2 Kjo dhomë të jetë në përputhje me kushtet teknike dhe ato të sigurisë të njëllajta me ato të dhomave të sigurisë për muret, tavanin, dyshemenë, dritaren.
- 7.3 Në këtë dhomë vendosen tavolina pune e karrige për të qëndruar ulur e punuar përfaqësuesit e organit të akuzës (oficer i policisë gjyqësore apo prokurori), avokati mbrojtës /përfaqësuesi ligjor, si dhe i ndaluarit/arrestuari.
- 7.4 Këto orendi janë ndërtuar prej materiali druri dhe të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme e të pa çmontueshme lehtësisht.
- 7.5 Ndriçimi elektrik duhet të jetë i plotë, i vendosur në tavan dhe komandohet nga koridori.
- 7.6 Dera e dhomës është prej material druri dhe nga ana e brendshme e veshur me materiale për të mos lejuar dëgjimin e bisedave jashtë kësaj dhome (sfungjer, pambuk). Kjo derë është pa sportel.
- 7.7 Ndalohet mbajtja në këto dhoma të orendive, sendeve apo pajisjeve të tjera që shkaktojnë presion apo dhunë psikologjike tek të ndaluarit e arrestuarit, që mund të shërbejnë si mjet dhune, të kablllove, tubove e përcjellave jashtë murit e dyshemesë.

8. Rregullat e sigurisë dhe pajisjet që mbahen në dhomën e vizitave mjekësore

- 8.1 Brenda sistemit të dhomave të sigurisë, krijohet dhe funksionon një mjedis i veçantë i cili shërben si dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga personeli përkatës.
- 8.2 Kushtet e sigurisë, të ajrimit, ndriçimit dhe ngrohjes në këtë ambient janë të njëllajta me ato të ambientit të dhomës së qëndrimit e paradhomës në sistemin e dhomave të sigurisë.
- 8.3 Në këtë dhomë lejohet të mbahen këto pajisje dhe orendi :
 - a) Tavolinë pune e mjekut e fiksuar në dysheme dhe e pa lëvizshme.

- b) Karrige pune.
- c) Raft druri/metalik apo kasafortë e mbyllur me bravë për mbajtjen e barnave të ndryshme mjekësore dhe të dokumentacionit për shërbimin mjekësor.
- d) Shtrat druri/hekuri i posaçëm për kryerjen e vizitave dhe kontrolleve mjekësore ndaj të arrestuarve/ndaluarve.
- e) Pajisje për ngrohje (të njëlljoita me ato që janë në paradhomat e dhomave të sigurisë).

9. Ambienti për larjen e trupit

- 9.1 Brenda sistemit të dhomave të sigurisë ndërtohen dhe funksionojnë ambiente të posaçme që shërbejnë për larjen e trupit të arrestuarve/ndaluarve.
- 9.2 Numri i këtyre ambienteve (dusheve) është në varësi të kapaciteteve mbajtëse të dhomave të sigurisë dhe nga dinamika që ka në këto ambiente.
- 9.3 Nyje e dysheve janë të ndarë nga njëri tjetri me mur me lartësi deri në tavan, për të siguruar privatësinë e të arrestuarit/ndaluarit nga njëri tjetri.
- 9.4 Kushtet teknike të ndërtimit, sigurisë dhe ato funksionale në këto ambiente jepen si më poshtë :
 - a) Ambientet e dusheve të kenë derë duralumini, ku kasa dhe fleta e derës të jenë 100% d/alumin.
 - b) Pjesa e poshtme e derës të jetë në lartësinë 30 cm nga niveli i dyshemesë.
 - c) Menteshat e derës të vendosen në krahë të kundërt me njëra tjetrën për të evituar çmontimin e fletës së derës.
 - d) Ndalohet vendosja e xhamave në derën e nyjës së dusheve.
 - e) Mbyllja e këtyre dyerve bëhet vetëm me dorezën e bravës (pa çelës) e cila vendoset vetëm në anën e jashtme të derës për tu mbyllur e hapur nga punonjësi i shërbimit.
 - f) Bolieri i ujit të ngrohtë të jetë i tipit horizontal dhe vendoset në ambientin para hyrjes për në nyjën e dushit, në lartësinë sa më afër tavanit. Kabllot e furnizimit me energji elektrike inkasohen brenda në mur dhe komandimi i rezistencës së bolierit bëhet nga një automat i vendosur në korridor.
 - g) Në ambientin e dushit vendosen pjatat e dusheve të cilat fiksohen në drejtimin përballë derës.
 - h) Në ambientin e dushit të jenë të dukshme vetëm çelësat/rubinetet për komandimin e ujit të ngrohtë e të ftohtë.
 - i) Koka e dushit vendoset në lartësinë jo më pak se 2.5 metër e fiksuar në mur dhe e pa çmontueshme pa përdorur pajisje të posaçme.
 - j) Grupi i dushit (jo grup vaske me hundëz) bashkë me linjën për tek koka e dushit të jenë të inkasuar e fshehura në mur.
 - k) Vendi për mbajtjen e sapunit apo shampove të jetë i ndërtuar në thellësi të murit (ne formën e një kamareje) me përmasa 25 x 20 x 10 cm e cila të jetë e veshur me pllakë porcelani apo qeramike.

- 9.5 Shtrimi i dyshemesë dhe veshja e mureve të dusheve bëhet me pllakë porcelani apo qeramike të cilat të jenë të pa çmontueshme me forcën e dorës apo krahut, pa përdorur mjete e pajisje të posaçme.
- 9.6 Ndalohet që në këtë ambient të ketë tubo, kablllo apo materiale e sende të tjera të dukshme mbi sipërfaqen e murit apo dyshemesë.
- 9.7 Peshqiri për fshirje të trupit mbahet dhe vendoset në pjesën e sipërme të derës së duraluminit, në mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm nga personeli i shërbimit.
- 9.8 Monitorimi i personit të arrestuar/ndaluar që kryen banje të trupit bëhet nga jo më pak se dy punonjës policie (përgjegjësi/zëvendës përgjegjësi i dhomave të sigurisë dhe një punonjës tjetër policie) të cilët të jenë të të njëjtit seks me personin që kryen banjën.
- 9.9 Në rast se në këto ambiente ka dritare për ajrim dhe ndriçim ato duhet të plotësojnë të njëjtat kushte të sigurisë si ato të dhomave apo paradhomave të ambienteve të sigurisë, me përjashtim të xhamit të dritares i cili duket të jetë jo transparent për të mos lejuar shikimin nga persona të tjerë jashtë këtyre ambienteve.
- 9.10 Ndriçimi i dusheve të bëhet nga ambienti/sheshi para hyrjes për në dushe i cili të jetë në tavan dhe i mjaftueshëm për të ndriçuar ambientin.
- 9.11 Në ambientin para hyrjes për në kabinat e dusheve vendoset një pajisje VC-je e cila përdoret nga personeli i shërbimit policor.

IX. RREGULLAT PËR HYRJEN DHE KONTROLLIN NË DHOMAT E SIGURISË

1. Personat që kanë të drejtë të hyjnë dhe kontrollojnë/inspektojnë dhomat e sigurisë.

Hyrja në dhomat e sigurisë bëhet për kontroll, inspektim, ndjekje e verifikim të ankesave e kërkesave, takime me të arrestuarit/ndaluarit, vizita mjekësore, etj.

1.1 Kanë të drejtën e kontrollit në dhomat e sigurisë :

- a) Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit.
- b) Drejtorë e Përgjithshëm në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
- c) Punonjësit e strukturave të Drejtorisë së Standardeve Profesionale, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
- d) Drejtori i Rendit Publik, Shefi i Sektorit të Rendit Publik dhe specialistet e sektorit të rendit, në Drejtorinë e Rendit Publik.
- e) Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Drejtorisë vendore të policisë.
- f) Shefi i sektorit, seksionit dhe specialisti i rendit në drejtorinë vendore të policisë.
- g) Shefi i komisariatit të policisë, shefi i seksionit të patrullës së përgjithshme/rendin publik dhe specialistë të këtij seksioni, në komisariatit e policisë.
- h) Specialistë e ndihmës specialistë të shërbimit të sallës së komandimit dhe ndihmës specialist për informacionin në drejtoritë e komisariatet e policisë.
- i) Personeli mjekësor i njësisë policore.

- j) Personel tjetër ndihmës si: mjekë të institucioneve mjekësore, elektrikist, hidraulikë, muratorë, etj me miratim të shefit komisarariatit të policisë.

1.2 Ambientet e dhomave të sigurisë mund të vizitohen dhe inspektohen pa autorizim të veçantë nga :

- a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, deputetet e kuvendit, Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Avokati i Popullit, komisionerë dhe ndihmës komisionerë të tij.
- b) Prokurorët e prokurorisë së rrethit gjyqësor përkatës, prokurorë të Gjykatës për Krime të Rënda, prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme gjatë ushtrimit të detyrës.
- c) Persona të tjerë që shoqërojnë personat e përmendur në pikën "1.2" të pikës 1, por jo më shumë se dy persona.
- d) Avokatët mbrojtës dhe kujdestarët ligjore për të miturit.
- e) Përfaqësues të Drejtorisë së Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, në Ministrinë e punëve të Brendshme.
- f) Përfaqësues të përfaqësive diplomatike e konsullore të akredituara në vendin tonë, vetëm për takimet me shtetasit e shtetit që përfaqësojnë apo shtetas të tjerë, për të cilët kanë marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave të tyre.

1.3 Me leje/autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm për Sigurinë Publike, hyjnë në dhomat e sigurisë :

- a) Përfaqësuesit e organizmave ndërkombëtare të OKB-së dhe KE-së për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- b) Përfaqësues të organizatave (OJQ/OJF) vendase për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

1.4 Hyrja në ambientet e dhomave të sigurisë e gazetarëve dhe përfaqësuesve të medieve vizive kryhet me leje/autorizim të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

1.5 Ndalohet dhënia/transmetimi direkt i rubrikave/emisioneve televizive nga dhomat e sigurisë.

1.6 Të gjithë personave të përcaktuar në pikat "1.1", "1.2", "1.3" dhe "1.4" të pikës 1 të kreut të IX -të, ju ndalohet të hyjnë në këto ambiente duke pasur armatim me vete, aparate telefonike celularë, apo sende të tjera që mund të cenojë elementët e sigurisë.

1.7 Armatimi dhe sendet e tjera personale, dorëzohen dhe mbahen në ruajtje jashtë ambienteve të sistemit të dhomave të sigurisë nga shërbimi i Sallës së Komandimit/ndihmës specialisti për informacionin, duke bërë regjistrimin e tyre në një libër të veçantë.

1.8 Para hyrjes në ambientet e dhomave të sigurisë të personave që kanë të drejtë të hyjnë pa autorizim të veçantë, personeli i shërbimit të Sallës së Komandimit/ndihmës specialisti për informacionin, apo përgjegjësi/zëvendës

përgjegjësi i dhomave të sigurisë vënë dijeni menjëherë titullarin e njësisë policore.

2. Rregullat për ushtrimin e kontrolleve në dhomat e sigurisë.

2.1 Personeli policor i ngarkuar me shërbim në dhomat e sigurisë dhe eprorët e tyre kanë të drejtë dhe detyrë që të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm për zbatimin me korrektësi të normave e rregullave të vendosura për ruajtjen, sigurimin dhe trajtimin e të ndaluarve e arrestuarve, lidhur me :

- a) Normat dhe parametrat e sigurisë të këtyre ambienteve.
- b) Përmbushjen e kushteve higjieno - sanitare të ambienteve të qëndrimit, jetesës dhe ato personale.
- c) Mënyrën e trajtimit dhe shkallën e garantimit e zbatimit të drejtave që kanë të arrestuarit/ndaluarit.
- d) Dëgjimin, evidentimin, raportimin, ndjekjen e trajtimin e pretendimeve apo ankesave të arrestuarve/ndaluarve për shkeljen e të drejtave të tyre.
- e) Kontrollin ndaj zbatimit të rregullave të kryerjes së shërbimit nga punonjësit e policisë.

2.2 Kontrollat në këto ambiente ushtrohen duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin njerëzor të arrestuarve/ndaluarve pa diskriminim. Kontrolli kryhet nga persona që kanë të njëjtin seks me të arrestuarit dhe të ndaluarit.

2.3 Funkcionet policore dhe afatet e kryerjes së kontrolleve në ambientet e dhomave të sigurisë, janë :

- a) Përgjegjës/zëvendës përgjegjësi i dhomave të sigurisë, në D.V.P/komisariatit e policisë : çdo ditë.
- b) Ndihmës specialist për shoqërimin e sigurinë (për D.V.P Tiranë) : çdo ditë.
- c) Specialisti i seksionit të rendit publik/patrullës së përgjithshme, në komisariatit e policisë : çdo ditë.
- d) Specialisti për shoqërimin dhe sigurinë (për D.V.P Tiranë) : çdo ditë.
- e) Shefi i seksionit të rendit publik/patrullës së përgjithshme në komisariatit e policisë : çdo shtatë ditë.
- f) Shefi i seksionit të sigurisë dhe shoqërimit (për D.V.P Tiranë) : çdo pesë ditë.
- g) Shef i komisariatit të policisë : çdo dy javë.
- h) Specialist në sektorin e rendit publik, në D.V.P : çdo dy javë.
- i) Shef i sektorit të rendit publik, në D.V.P : çdo njëzet ditë.
- j) Zëvendësdrejtor i D.V.P për Sigurinë Publike, në D.V.P Tiranë : çdo muaj.
- k) Zëvendësdrejtor për hetimin e krimeve dhe sigurinë publike, në D.V.P : çdo muaj.
- l) Drejtor i D.V.P : çdo dy muaj.

2.4 Pas përfundimit të kontrollit bëhen shënimet përkatëse në librin e kontrolleve dhe për të metat e konstatuara lihen detyra për marrjen e masave përkatëse.

2.5 Gjatë ushtrimit të kontrolleve ndalohet pyetja e të arrestuarve/ndaluarve për veprën penale që kanë kryer apo akuzohen, rrethanat e kryerjes së saj, etj.

X. RREGULLAT DHE MASAT E SIGURISË GJATË VEPRIMEVE ME TE NDALUARIT/ARRESTUARIT, JASHTË DHOMAVE TE SIGURISE

1. Lëvizjet dhe shoqërimet jashtë dhomave te sigurisë.

1.1 Të arrestuarit/ndaluarit nxirren dhe shoqërohen jashtë sistemit të dhomave të sigurisë, në këto raste:

- a) Për t'i dërguar në seancat gjyqësore për shqyrtimin, vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurimit, sipas njoftimit me shkrim të gjykatës.
- b) Për dhënie ndihme mjekësore në qendrat spitalore rajonale apo në ato të specializuara.
- c) Për transferim në dhomat e sigurisë të komisariateve të tjera të policisë, për çështje sigurie dhe mungesë hapësirash e kushtesh, duke vënë në dijeni drejtuesit e prokurorisë së rrethit gjyqësor.
- d) Për veprime të tjera hetimore-procedurale sipas vendimit përkatës të prokurorisë ose gjykatës.
- e) Raste të rënies së zjarreve, tërmeteve, përmbytjeve apo ndodhjes së fatkeqësive të tjera natyrore duke i dërguar në ambiente të komisariateve të policisë më të afërt.
- f) Për t'u transferuar në IEVP të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

1.2 Shoqërimi dhe transferimi i personit arrestuar/ndaluar realizohet mbi bazën e dokumenteve që vërtetojnë nevojën e kryerjes së kësaj lëvizje dhe urdhrit administrativ/të brendshëm të lëshuar nga :

- a) Shefi i Komisarariatit të policisë për shoqërimet e lëvizje brenda juridiksionit të komisarariatit të policisë.
- b) Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë për lëvizje e transferime jashtë juridiksionit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

2. Rregullat e përgjithshme gjatë transferimit dhe lëvizjes.

2.1 Rregullat e përgjithshme që zbatohen në rastet e transferimit dhe lëvizjeve të personave të arrestuar/ndaluar, janë si më poshtë:

- a) Përlllogaritja dhe raporti i numrit të punonjësve të policisë për çdo të arrestuar/ndaluar të jetë, jo më pak se dy punonjës policie.
- b) Kur janë më shumë se tre të arrestuar/ndaluar, numri i punonjësve të policisë, caktohet me urdhër të Drejtorit/shefit të komisarariatit të policisë. Në këtë rast gjithmonë numri i punonjësve të policisë minimalisht duhet të jetë një më shumë se numri i të arrestuarve dhe ndaluarve.

2.2 Shoqërimi i të arrestuarve/ndaluarve në çdo rast bëhet vetëm gjatë ditës (pas lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij). Në raste të defekteve të automjeteve, avarive dhe të papriturave të tjera, vendosja dhe sigurimi tyre bëhet përkohësisht në komisariatin e policisë më të afërt. Në këtë rast vihet në dijeni menjëherë Shërbimi Sallës Komandimit, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

2.3 Lëvizja e shoqërimi bëhet duke i mbajtur të prangosur, me duar para, ose kur janë dy persona mund të lidhen me pranga dorë në dorë me njeri-tjetrin.

- 2.4 Patrulla e policisë së shërbimit të jetë e pajisur me armatim personal (pistoletë, automatik e municionin përkatës), jelekë antiplumb, aparat telefonik të komunikimit brenda Policisë së Shtetit dhe radiondërlidhje me të gjitha kanalet e komisariateve ku do të kalojnë.
- 2.5 Lëvizja e shoqërimi i të arrestuarve e të ndaluarve bëhet me automjete të veçanta (autoburgje) dhe kur nuk ka të tillë shoqërimi bëhet me automjete të tjera të shërbimit policor.
- 2.6 Në rastet kur me të arrestuarin/ndaluarin kryhen veprime të ndryshme hetimore (eksperimente hetimore, këqyrje, etj), bëhet dyfishimi i numrit të punonjësve të policisë që do të sigurojnë atë dhe ambientin përreth. I arrestuari/ndaluari duhet të mbahet me duar të lidhura prapa duke marrë të gjitha masat e sigurisë sipas veçorive të terrenit dhe llojit të veprimit hetimor që do të kryhet, për parandalimin e ngjarjeve negative dhe me pasoja.
- 2.7 Të ndaluarit e arrestuarit, para se të vendosen në automjet i bëhet kontroll fizik i automjetit dhe të arrestuarit të cilit i kërkohet të zbatojë këto rregulla:
- Të mos tentojë të largohet me forcë nga automjeti, salla e gjyqit, dhoma e mjekimit apo vende të tjera ku mbahet apo kryhen veprimet.
 - Të mos komunikojë me persona të tjerë në automjet apo ambientet ku do të qëndrojnë.
 - Të tregohet i disiplinuar e të mos çohet në këmbë apo të flasë pa leje të trupit gjykues, gjatë seancës gjyqësore.
 - Për nevoja personale të komunikojë me përgjegjës të patrullës të shërbimit.
- 2.8 Lëvizja e shoqërimi i të ndaluarve e arrestuarave, bëhet me punonjës policie të të njëjtit seks, ndërsa të sëmuret përveç punonjësve të policisë shoqërohen dhe nga personeli mjekësor i drejtorisë/komisariatit të policisë.

3. Rregullat dhe masat përgatitore për transferimin e të arrestuarve/ndaluarve apo të dënuarve.

- 3.1 Shefi i sektorit/seksionit për rendin publik/patrullës së përgjithshme/shoqërimin dhe sigurisë në drejtori/komisariat policie, përgatit urdhrin me shkrim për shoqërim e transferim, të cilin e dërgon për miratim (firme) tek titullari drejtorisë/komisariatit. Urdhri i shërbimit duhet të përmbajë: datën, vendin, patrullën e përgjegjës të patrullës (emër, mbiemër gradë), destinacionin, itinerarin e lëvizjes, automjetin (tipi, targa), orën e nisjes, etj.
- 3.2 Instruktimi dhe dhënia e detyrave për patrullën e shërbimit kryhet nga përgjegjësi i strukturës së rendit publike në drejtori/komisariat. Për rastet kur i arrestuari apo i ndaluar paraqet rrezikshmëri të theksuar dhe kur janë më shumë se dy persona, përgjegjësi i patrullës caktohet një punonjës policie i nivelit të parë drejtues.
- 3.3 Para nisjes për shoqërim, përgjegjësi i dhomave të sigurisë dhe përgjegjësi i shërbimit të patrullës kontrollojnë nëse të ndaluarit e arrestuarit janë prangosur sipas rregullave.

- 3.4 Përgjegjësi i shërbimit të patrullës gjatë lëvizjes mban kontakte të vazhdueshme me eprorin e tij deri në përfundim të shërbimit.
- 3.5 Përgjegjësi i dhomave të sigurisë i dorëzon përgjegjësit të patrullës së shoqërimit me procesverbal të arrestuarit e të ndaluarit, sendet personale kur ka të tilla si dhe fashikullin me dokumentet përkatëse të tij. Procesverbali i dorëzimit plotësohet në dy kopje ku një mbahet nga përgjegjësi i patrullës së shërbimit dhe tjetra nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

4. Rregullat e sigurisë për shoqërimin/qëndrimin në gjykatë.

- 4.1 Shërbimet e patrullave të përgjithshme apo shërbime të tjera policore marrin masa për sigurimin e rendit në hyrje të gjykatave duke kontrolluar personat që hyjnë në sallë për armë zjarri apo sende të tjera të forta.
- 4.2 Të arrestuarit/ndaluarit dërgohen në seancat gjyqësore para fillimit të seancës. Me hyrjen e trupit gjykues personeli policor dhe arrestuari/ndaluari çohen në këmbë, dhe më pas këtyre të fundit u hiqen prangat e u vendosen me përfundimin e seancës gjyqësore. Ata nxirren nga salla pasi të ketë përfunduar seanca gjyqësore.
- 4.3 Përgjegjësi i patrullës ka për detyrë të kontrollojë sallën ku do të zhvillohet seanca gjyqësore, vendin ku do të qëndrojnë të arrestuarit/ndaluarit gjatë seancave gjyqësore, rrugët e hyrjes dhe të daljes nga salla.
- 4.4 Gjatë pushimeve të seancave apo lëvizjeve të ndryshme, merren masa për të siguruar të ndaluarit e arrestuarit nga tentativa të mundshme që mund të kryhen për ti takuar, folur me ta apo liruar me forcë nga familjarë apo persona të tjerë.

5. Rregullat e sigurisë gjatë trajtimit në qendrat spitalore.

- 5.1 Trajtimi i të ndaluarve e arrestuarve në qendrat rajonale spitalore, bëhet në dhoma/ambiente të veçanta të tyre të cilat duhet të plotësojnë këto kushte sigurie:
- a) Të ketë ndarje të dhomës me zgarë hekuri në dhomë dhe paradhomë.
 - b) Dritaret të jenë të siguruara me zgarë hekuri me shufra me seksion jo më pak se 16 - 18mm, e me kuadrate 15 x15 cm.
 - c) Dera që ndan dhomën me paradhomën të mbyllet me bravë apo dry.
 - d) Tualeti për kryerjen e nevojave të jetë brenda në dhomë dhe në pamundësi të ketë dritare të siguruar si dritarja e dhomës.
- 5.2 Në rast se dhoma/ambienti spitalor nuk përmbush kushtet e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren masa të tjera shtesë për ruajtjen e sigurimin e të arrestuarit/ndaluarit. Këto masa planifikohen dhe zbatohen në varësi dhe në proporcionalitet me shkallën e rrezikshmërisë që paraqet personi, precedentët penale që ka, gjendjes shëndetësore, shkallën e dëmtimeve fizike të

- tij, kohëzgjatjen e qëndrimit të tij për trajtim mjekësor, ambientin ku do të mbahet e trajtohet, etj.
- 5.3 Shërbimi për sigurimin e të ndaluarve/arrestuarve në institucionet mjekësore kryhet me jo më pak se dy punonjës policie, njëri prej të cilëve qëndron brenda në dhomë.
 - 5.4 Dera që ndan paradhomën nga dhoma qëndron gjithmonë e mbyllur dhe çelësi mbahet nga punonjësi i policisë që qëndron në korridor apo paradhomën e ambientit.
 - 5.5 Punonjësi i policisë i cili qëndron në paradhomë ose korridor, kryen shërbimin me armatim personal (automatik dhe pistoletë), ndërsa punonjësi policisë që qëndron në ambientin e qëndrimit të arrestuarit/ndaluarit nuk mban asnjë lloj armatimi.
 - 5.6 Nxjerrja e të arrestuarit/ndaluarit jashtë dhomës për në tualet apo ambiente të tjera të spitalit, bëhet i lidhur me pranga në duar përpara dhe i shoqëruar nga dy punonjësit e policisë. Njëri e mban të kapur nga krahu dhe tjetri e shoqëron nga pas me armë.
 - 5.7 Në varësi të rrezikshmërisë që paraqet, gjendjes shëndetësore dhe ambienteve ku do të kryen ekzaminime të tjera mjekësore përcaktohen e zbatohen masa shtesë për ruajtjen dhe sigurimin e tij duke shtuar numrin e punonjësve të policisë.
 - 5.8 Të gjitha vizitat, kontrollet/ekzaminimet e trajtimet mjekësore në këto ambiente nga personeli mjekësor ndaj të arrestuarit/ndaluarit kryhen domosdoshmërisht në prezencë dhe nën mbikëqyrjen e punonjësit të policisë.
 - 5.9 Para se të arrestuarit/ndaluarit të shoqërohen për në tualet, nga punonjësit e policisë bëhet kontrolli fizik i ambientit të tualetit.
 - 5.10 Në rastet kur dritarja e tualetit është e pa siguruar, para nxjerrjes merren masa për sigurimin e jashtëm të dritares me punonjës të tjerë policie.
 - 5.11 Në një dhomë mund të mbahen, trajtohen dhe sigurohem më shumë se një i arrestuar/ndaluar. Në këto raste shërbimi për ruajtjen e sigurimin e tyre kryhet nga jo më pak se tre punonjës policie.
 - 5.12 Ndalohet mbajtja dhe qëndrimi në këto ambiente i personave të tjerë që nuk janë personel shëndetësor i ngarkuar me trajtimin mjekësor të arrestuarit/ndaluarit.
 - 5.13 Ndalohet hyrja e realizimi i takimeve të arrestuarit/ndaluarit me familjarët, të afërmit apo persona të tjerë.

XI. RREGULLAT PËR ADMNISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE ÇELSAVE TE DHOMAVE TE SIGURISE

1. Dokumentacioni që mbahet e administrohet në dhomat e sigurisë

- 1.1 Nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë në një raft të veçantë brenda sistemit dhomave të sigurisë mbahen dhe administron këto dokumente :
 - a) Regjistri i evidentimit të personave të arrestuar/ndaluar.
 - b) Regjistri i sendeve personale të arrestuarve/ndaluarve.
 - c) Regjistri marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore,

- d) Regjistri i takimeve të të arrestuarve/ndaluarve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut (OJQ e OJF), Avokatin e Popullit etj.
 - e) Regjistri i evidentimit të vizitave mjekësore që kryhen menjëherë pas arrestimit/ndalimit, gjatë kohës së qëndrimit të dhomat e sigurisë, në qendrat spitalore.
 - f) Libri i marrjes, dorëzimit të shërbimit të sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme të dhomave të sigurisë.
 - g) Libri i kontrolleve të kryera në dhomat e sigurisë.
 - h) Fashikujt (dosjet) personale për çdo të arrestuar/ndaluar me dokumentet sipas përcaktimit në pikën "10.1" të pikës 10, në Kreun e V - të.
 - i) Fashikull për administrimin e kopjeve të deklaratës për njohjen e të drejtave nga të arrestuarit/ndaluarit, me nënshkrimin e tyre.
 - j) Dosje për administrimin e procesverbaleve për: dorëzimin e të arrestuarve/ndaluarve, të dorëzimit të sendeve personale si dhe urdhrat për transferime e shoqërime jashtë dhomave të sigurisë.
 - k) Lista e punonjësve të policisë që shërbejnë në dhomat e sigurisë dhe lista e personelit ndihmës teknik që lejohet të hyjnë në dhomat e sigurisë, të miratuara nga drejtori i policisë së vendore/shefi i komisariatit të policisë.
 - l) Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit për sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve në qendrat spitalore.
 - m) Regjistri i takimit të nënës me fëmijën për ushqyerjen me gjë.
 - n) Regjistri takimeve të personave të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, me pjesëtarë të familjes.
 - o) Regjistri i kërkesë/ankesave të personave të privuar nga liria.
- 1.2 Te gjithë librat e shërbimit e regjistrat regjistrohen me numër fletësh në sekretari, dhe pas përfundimit të tyre dorëzohen tek kjo e fundit duke u ruajtur sipas afateve të përcaktuara për to.
- 1.3 Të gjitha të dhënat e mbledhura e pasqyruara për të arrestuarit/ndaluarit sipas përcaktimeve të bëra në pikën "6" të nenit 112 të Ligjit 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", kur pushohet çështja penale në ngarkim të personit apo shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë, me kërkesën e të interesuarit - asgjësohen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

2. Rregullat për administrimin e çelësave të dhomave të sigurisë.

- 2.1 Dera e hyrjes kryesore për në dhomat e sigurisë mbyllet dhe sigurohet me dy dryna të cilët duhet të administrohen në kopje të vetme nga dy punonjës policie të ndryshëm. Dera hapet në prani të përgjegjësit/zëvendës përgjegjësit të dhomave të sigurisë, specialistit të sallës së komandimit/ndihmës specialistit për informacionin dhe një punonjësi tjetër policie.
- 2.2 Gjatë kryerjes së veprimeve brenda në dhomat e sigurisë dera kryesore mbahet e mbyllur si dhe një nga punonjësit e policisë të përcaktuar në pikën "a" së bashku me njërin prej çelësave qëndron gjithmonë jashtë ambienteve të këtyre dhomave.

- 2.3 Sa herë që përgjegjësi i dhomave të sigurisë largohet nga drejtoria/komisariati i policisë, dorëzon çelësat e dyerve të dhomave një punonjësi policie që është ngarkuar për ta zëvendësuar.
- 2.4 Çelësat rezervë të gjithë dyerve të dhomave dhe të dyerve të hyrjes në këtë ambient, mbahen në zarfe të mbyllura e vulosura dhe ruhen në kasafortën e shërbimit të sallës Komandimit apo shërbimin e ndihmës specialistit për informacionin në drejtori/komisariat, për tu përdorur në raste emergjence, ku dhe në këto raste zbatohen kufizimet e përcaktuara në këtë nen.

XII. RREGULLI, DISIPLINA, MASAT DISIPLINORE DHE MJETET E PËRDORIMIT TË FORCËS

1. Shkelja e rregullave nga të arrestuarit/ndaluarit dhe masat ndaj tyre.

- 1.1 Personeli i shërbimit policor, bazuar në kërkesat e kësaj procedure kërkojnë nga të arrestuarit/ndaluarit zbatimin e rregullave e normave të vendosura për regjimin e brendshëm, orarin e veprimeve ditore, etj.
- 1.2 Konsiderohen shkelje të rregullit e disiplinës së brendshme veprimet dhe mosveprimet e mëposhtme :
- a) Moszbatimi i detyrave për kryerjen e pastrimit personal, dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.
 - b) Sjellja jo korrekte dhe agresive ndaj të arrestuarve e ndaluarve të tjerë, ose personelit të shërbimit.
 - c) Përdorimi i fjalëve fyese, ofendues e të pahijshme ndaj të ndaluarve e arrestuarve të tjerë.
 - d) Simulimi i sëmundjes dhe veprimeve të tjera me qëllim përfitimi.
 - e) Mbajtja, përdorimi dhe shpërndarja e sendeve të ndaluara.
 - f) Moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të personelit të shërbimit.
 - g) Përvetësimi ose dëmtimi me dashje i orendive, pajisjeve e ambienteve të dhomave ose të sendeve personale të arrestuarve e ndaluarve të tjerë.
 - h) Organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e çrregullimeve në ambientet e dhomave të sigurisë.
- 1.3 Për shkeljen e rregullave të përcaktuara në pikën "1.2" të pikës 1, ndaj të ndaluarve e arrestuarve merren këto masa disiplinore:
- a) Qortim e vërejtje individuale.
 - b) Ndërprerje të dhënies së cigareve deri në dy ditë.
 - c) Përshkrimin e sjelljes së keqe në një relacion për organin e hetimit dhe gjykatën me qëllim mbajtjen në konsideratë si rrethanë rënduese në caktimin e masës së sigurisë apo atë të dënimit. Relacioni për përshkrimin e sjelljes të vendoset në fashikullin personal.
- 1.4 Për çdo shkelje të rregullit e disiplinës nga të arrestuarit/ndaluarit punonjësit e policisë përpilojnë raport shërbimi dhe ja paraqesin eprorit të drejtpërdrejtë.
- 1.5 Masat disiplinore ndaj personave të arrestuar/ndaluar jepen nga shefi i sektorit të rendit publik në Drejtorinë e Policisë të Vendore, shefi i seksionit të patrullës së përgjithshme/rendit publik në komisariatit e policisë, duke vënë në dijeni

drejtuesin e njësisë policore (drejtorin e drejtorisë vendore/shefin e komisariatit të policisë).

- 1.6 Ekzekutimi i masës disiplinore të dhënë ndërpritet në rastet kur i arrestuari/ndaluar ka bërë ankesë tek drejtuesit e njësisë policore, deri në sqarimin e trajtimin e ankesës, përjashtuar rastet kur veprimet apo mosveprimet përbëjnë vepër penale.
- 1.7 Për shkeljet e tjera që përbëjnë vepër penale kryhen veprimet procedurale sipas kërkesave të Kodit të Procedurës penale dhe referimi i tyre në organin e prokurorisë.

2. Mjetet e forcës dhe të shtrëngimit fizik dhe rregullat për përdorimin e tyre.

- 2.1 Përdorimi i forcës dhe mjeteve të forcës kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore :
 - a) Nenit 133 të Ligjit nr. 108, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”.
 - b) VKM nr. 293, datë 8.4.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuro-paralizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia e shtetit”
 - c) Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për miratimin e procedurave standarde të Departamentit të Sigurisë Publike “Për përdorimin e forcës”.
 - d) Përcaktimeve të bëra në këtë Procedure.
- 2.2 Para dhe gjatë përdorimit të forcës, duhet të respektohen këto kërkesa:
 - a) Të jetë i përshkallëzuar dhe i kufizuar në kohë ku të përfshihen: bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, dhe armë zjarri.
 - b) Të përdoret vetëm kur kjo është e nevojshme dhe kur të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.
 - c) Të përdoret në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
 - d) Të bëhet paralajmërim para se të përdoret forca dhe në rastet kur rrethanat nuk e lejojnë të përdoret pa paralajmërim (në rastet kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit).
- 2.3 Përdorimi i forcës në ambientet e dhomave të sigurisë duhet të kryhet nën drejtimin e një punonjësi policie të nivelit të parë drejtues dhe në raport të drejtë me shkallën e përdorimit të dhunës nga i arrestuari/ndaluar.
- 2.4 Me ndërprerjen e veprimeve e kundërshtimeve nga i arrestuari/ndaluar, ndërpritet menjëherë përdorimi i forcës.
- 2.5 Në të gjitha rastet kur si rezultat i përdorimit të forcës ka të dëmtuar, personeli i shërbimit jep menjëherë ndihmë duke përfshirë dhe atë mjekësore, njoftohet mjeku për ekzaminime të specializuara mjekësore, përpilohet raport shërbimi i veçantë, si dhe njoftohet organi i prokurorisë.
- 2.6 Përdorimi i mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik bëhet në bazë të procedurave standarde të miratuara, vetëm në rastet për të shmangur :

- a) Përpjekjet për t'u larguar me forcë apo arratisur nga dhomat e sigurisë, sallat e gjykatave, qendrat spitalore apo nga mjetet gjatë transportit të tyre.
- b) Dhunën ndaj të ndaluarve e arrestuarve të tjerë ose personelit të shërbimit.
- c) Veprimet e dhunshme për të dëmtuar shëndetin apo vetëvlarë.
- d) Dëmtimin e rëndë të sendeve, pajisjeve e orendive të përbashkëta të dhomave të sigurisë.
- e) Kundërshtimin apo rezistencën aktive dhe pasive në zbatimin e urdhrave për lëvizje apo transferimin e detyrueshëm.

XIII. VEPRIMET DHE PROCEDURAT KUR KA NGJARJE TË RËNDA ME TË ARRESTUARIT DHE TË NDALUARIT

1. Masat në rastet e ngjarjeve të rënda.

1.1 Në rastet kur i arrestuari/ndaluari tenton të vetë dëmtohet :

- a) Punonjësi i shërbimit të sigurisë së brendshme informon menjëherë shërbimin e sallës komandimit/ndihmës specialistin për informacionin, si dhe eprorin e drejtpërdrejtë kur janë mundësitë e komunikimit, të cilët marrin masa për ndërprerjen e kësaj gjendjeje dhe sipas shkallës së dëmtimeve që mund të ketë pësuar i arrestuari/ndaluari jepet ndihma mjekësore.
- b) Për këto raste dhe veprime të kryera nga i arrestuari/ndaluari punonjësi i shërbimit të brendshëm përpilon raport shërbimi ku përshkruan datën, orën, numrin e dhomës, emrin e mbiemrin e të arrestuarit/ndaluarit, veprimet që janë kryer për vetëdëmtim, komunikimin e thirrjet që i ka bërë punonjësi i policisë për ndërprerjen e veprimeve, personin apo shërbimin që ka njoftuar, koha kur u ndërhy për parandalimin e ngjarjeve të rënda, kush ndërhyri, masat që u morën për dhënien e ndihmës personit të dëmtuar, etj.
- c) Drejtuesi i njësies policore vë në dijeni organin e prokurorisë së rrethit gjyqësor i cili gjykon dhe vendos për kryerjen e veprimeve hetimore në këtë rast.
- d) Kopje të raportit të shërbimit i vihen në dispozicion prokurorisë së rrethit gjyqësor dhe në fashikullin/dosjen e dokumenteve të arrestuarit/ndaluarit.

1.2 Në rastet e vdekjes së personit të arrestuar/ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë apo në qendrat spitalore gjatë trajtimit mjekësor :

- a) Njoftohet menjëherë shërbimi i sallës së drejtimit/ndihmës specialisti për informacionin, eprori i drejtpërdrejtë, drejtuesi i njësies policore dhe organi i prokurorisë së rrethit gjyqësor.
- b) Merren masa për ruajtjen e sigurimin e vendit të ngjarjes dhe pritjet ardhja e përfaqësuesve të organit të prokurorisë për kryerjen e veprimeve procedurale hetimore.
- c) Kryen veprime sipas urdhrave të prokurorit të çështjes, duke i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet e kërkuara si dhe personelin e shërbimit.

1.3 Në rastet kur i arrestuari/ndaluari plagoset ose vritet nga punonjësit e shërbimit gjatë tentativës për tu arratisur nga dhomat e sigurisë apo ambiente të tjera (automjete, gjykatë, qendra spitalore):

- a) Punonjësi i policisë që është me shërbim njofton menjëherë shërbimin e sallës së komandimit/ndihmës specialistin për informacionin, eprorin e drejtpërdrejtë, drejtuesin e njësisë policore dhe organin e prokurorisë të rrethit gjyqësor.
- b) Merr masa për dhënien e ndihmës së parë të nevojshme të dëmtuarit deri në ardhjen e punonjësve të tjerë të policisë në ndihmë.
- c) Siguron vendin e ngjarjes, viktimën (në rast se ka), ruan provat materiale e çdo gjë tjetër që ka lidhje me ngjarjen dhe pret ardhjen e grupit që do të kryejë veprimet procedurale hetimore.
- d) Siguron të dhëna për identitetin e personave që kanë qenë dëshmitarë okularë.
- e) Informon prokurorin apo oficerin e policisë gjyqësore për veprimet e kryera dhe situatën e krijuar.
- f) Vihet në dispozicion të organit të prokurorisë sipas kërkesës së këtyre të fundit.

1.4 Kur nga të arrestuarit/ndaluarit bëhen revolta e protesta me qëllim shpërthimin e dyerve, dritareve apo mureve dhe largimin nga ambientet e qëndrimit, merren këto masa :

- a) I gjithë personeli i shërbimit që disponon kopje të çelësave i dorëzon ato tek përgjegjësi i shërbimit të Sallës Komandimit në drejtori/komisariatit e policisë.
- b) Përforcohen masat dhe shërbimet për sigurimin e jashtëm të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe me shërbime të tjera policore.
- c) Njoftohen drejtuesit e komisariatit, Drejtorisë Vendore të Policisë, shërbimi i Sallës Komandimit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor.
- d) Veprimet për menaxhimin e situatës së krijuar kryhen në bazë të procedurës standarde të miratuar.

2. Ruajtja, siguri dhe evakuimi në situatë të veçantë.

2.1 Në rastet e situatave të jashtëzakonshme apo emergjencave civile, për ruajtjen, sigurimin dhe evakuimin e të arrestuarve/ndaluarve të veprohet sipas urdhrave të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe procedurave standarde të miratuara.

XIV. RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT DHE DETYRAT E PERSONELIT TË SHËRBIMIT POLICOR.

1. Organizimi, drejtimi dhe kryerja e shërbimit.

1.1 Organizimi, drejtimi, kontrolli/inspektimi i funksionimit të regjimit të brendshëm dhe i rregullave të sigurisë në ambientet e dhomave të sigurisë,

- kryhet nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, e cila e realizon një gjë të tillë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Sigurisë Publike .
- 1.2 Shërbimi për sigurimin e trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve planifikohet dhe kryhet nga strukturat dhe shërbimet e rendit publik të drejtorive/komisariateve të policisë dhe në raste të veçanta dhe nga struktura të shërbimeve të tjera të policisë.
 - 1.3 Punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në dhomat e sigurisë miratohen nga drejtori i drejtorisë vendore të policisë/shefi i komisariatit të policisë me propozim të shefit seksionit të patrullës përgjithshme/rendit publik.
 - 1.4 Funkcionet/shërbimet policore që kryejnë sigurimin e trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve janë :
 - a) Përgjegjës i dhomave të sigurisë.
 - b) Zevendëspërgjegjës i dhomave të sigurisë (një nga punonjësit e shërbimit të brendshëm apo të jashtëm) i caktuar në mungesë të përgjegjësit të dhomave të sigurisë.
 - c) Punonjës policie për shërbimin e sigurimit të brendshëm.
 - d) Punonjës policie për shërbimin e sigurimit të jashtëm.
 - 1.5 Shërbimi për ruajtjen, sigurimin e trajtimin organizohet dhe kryhet sipas Rregullores të Policisë së Shtetit dhe procedurave standardeve të miratuara për planifikimin e shërbimit policor.
 - 1.6 Punonjësit e policisë që planifikohen në këto shërbime të kenë një stazh pune jo më pak se tre vjet shërbimi në polici, të njohin aktet ligjore dhe nënligjore që sanksionojnë liritë dhe të drejtat e shtetasve të ndaluar dhe arrestuar, procedurat standarde të punës për respektimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të kësaj kategorie personash, si dhe kërkesat e kësaj procedure.
 - 1.7 Punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin për sigurimin e të ndaluarve e arrestuarve nuk duhet të kenë lidhje familjare, gjinore, shoqërore e miqësore e konflikt interesi me të arrestuarit e ndaluarit. Në raste të tilla, punonjësi i policisë duhet të njoftojë menjëherë eprorët të cilët marrin masa për zëvendësimin e tyre, deri në lirim apo transferimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve nga këto ambiente.
 - 1.8 Gjatë periudhës që në këto ambiente nuk ka të ndaluar dhe arrestuar, punonjësit e policisë të përcaktuar në pikën "1.4" të pikës 1, në Kreun e XIV -të, planifikohen e kryejnë shërbime të tjera të rendit publik.

2. Detyrat e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

- 2.1 Të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme ndaj infrastrukturës së dhomave të sigurisë, ndaj të ndaluarve e arrestuarve dhe ndaj shërbimeve të policisë për sigurimin e tyre.
- 2.2 Të kërkojë zbatimin e kërkesave e të rregullave për sigurimin dhe trajtimin e të ndaluarve dhe arrestuarve.
- 2.3 Të marrë në dorëzim personat që ndalohen dhe arrestohen nga oficerët e policisë gjyqësore me dokumentacionin përkatës sipas Kodit të Procedurës Penale e kërkesave të kësaj procedure.

- 2.4 Të ushtrojë kontroll fizik sipërfaqësor dhe të imët ndaj të arrestuarve/ndaluarve para se të hyjnë në dhomat e sigurisë.
- 2.5 Të marrë në dorëzim dhe në ruajtje të gjitha sendet personale të ndaluarve/arrestuarve sipas procesverbalit të kontrollit personal.
- 2.6 Të informoje me shkrim dhe me gojë eprorin e drejtpërdrejtë për problemet apo shqetësimet që lindin në ambientet e dhomave të sigurisë lidhur me sigurinë, respektimin e të drejtave të ndaluarve e arrestuarve, ankesat që kanë të ndaluarit e arrestuarit, kryerjen e shërbimit nga punonjësit e policisë, etj.
- 2.7 Të plotësojë dhe administrojë me përgjegjësi dhe sipas kërkesave të gjitha dokumentet e parashikuara në këtë procedure.
- 2.8 Të mos lejojë futjen në dhomat e sigurisë të ndaluarve dhe arrestuarve që nuk kanë dokumentacionin e plotë sipas përcaktimeve të bëra në nenin pikën 1 të Kreut të V-të.
- 2.9 Të kërkojë ndihmë nëpërmjet shefit seksionit patrullës përgjithshme/rendit publik në komisariatit e policisë për plotësimin e dokumentacionit përkatës për të ndaluarit dhe arrestuarit ndaj të cilëve është vendosur nga gjykata masa e sigurisë "arrest në burg".
- 2.10 Të ndjekë dhe zbatojë masa dhe detyra për transferimin e dorëzimin e arrestuarve/ndaluarve në IEVP të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
- 2.11 Të mos lejojë hyrjen në dhomat e sigurisë të atyre të ndaluarve e arrestuar ve ndaj të cilëve është ushtruar torturë, dhunë apo keqtrajtime të tjera fizike si dhe që kanë nevojë për ndihmë mjekësore.
- 2.12 Të dorëzojë sipas procesverbalit sendet personale të ndaluarit dhe arrestuarit kur lihet i lirë nga gjykata apo prokurori, duke hartuar dhe procesverbalin e dorëzimit.
- 2.13 Të bëjë të njohur të arrestuarit/ndaluarit të drejtat që ju njeh ligji duke i dhënë të nënshkruajë një deklaratë për këtë qëllim (sipas formatit dhe modelit Tip bashkëlidhur).
- 2.14 Të kontrollojë masat e sigurisë për sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve para se të kryhet shoqërimi për në gjykatë, qendër spitalore, transferimin për në IEVP apo ambiente të tjera dhe të ndërhyjë për plotësimin e tyre kur është e nevojshme.
- 2.15 Të dorëzojë të arrestuarin/ndaluarin kundrejt procesverbalit të dorëzimit personelit policor të ngarkuar për shoqërimin e tyre në gjykatë, qendër spitalore apo transferimin për në IEVP.
- 2.16 Të mos lejojë nxjerrjen e të ndaluarve dhe arrestuarve jashtë ambienteve të dhomave të sigurisë gjatë kohës së pushimit (fjetjes), dhe në raste të veçanta pa u marrë më parë masat e nevojshme të sigurisë sipas përcaktimeve në këtë procedure.
- 2.17 Të lejojë hyrjen në dhomat e sigurisë të personave të përcaktuar në pikën "1.3" të pikës 1, në Kreun e IX -të, pasi u ka kontrolluar më parë autorizimet/lejet përkatëse si dhe duke asistuar gjatë vizitave/inspektimeve të tyre.
- 2.18 Të zbatojë me korrektësi të gjitha këshillat dhe rekomandimet e lëna me shkrim nga mjeku për dhënien e barnave e të mjekimit personave të arrestuar/ndaluar.

- 2.19 Të japë vetë të arrestuarve/ndaluarve mjekime të lehta siç janë ato për dhimbje koke, etj.
- 2.20 Të kontrollojë zbatimin e rregullave për sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve gjatë qëndrimit për trajtim në institucionet mjekësore dhe për shkeljet e mangësitë e konstatuara të njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë.
- 2.21 Të informojë mjekun/ndihmësmjekun e drejtorisë/komisariatit policisë për mjekimin dhe rekomandimet e dhëna nga mjekët specialistë për të arrestuarit/ndaluarit që kanë marrë ndihmë në qendra të specializuara.
- 2.22 Të administrojë kopjet e çelave të dyerve të dhomave të sigurisë dhe mos ua dorëzojë ato personave të tjerë (me përjashtim kur nuk është në shërbim dhe është zëvendësuar nga punonjës tjetër me urdhër të eprorit të tij direkt).
- 2.23 Të hedhë në sistemin elektronik të dhënat për personat e ndaluar/arrestuar që kanë të bëjnë me :
- a) Vizitat mjekësore të kryera nga personeli mjekësor i policisë apo mjekë të tjerë të zgjedhur prej të arrestuarit/ndaluarit.
 - b) Realizimin e mbrojtjes me avokat, takimet e bëra me këtë të fundit.
 - c) Të dhëna për përfaqësuesin e akuzës që ka marrë në pyetje të arrestuarin/ndaluarin.
 - d) Takimet dhe intervistat e zhvilluara me të arrestuarit/ndaluarit nga ana e Avokatit të Popullit dhe OJQ/OJF.
 - e) Përfundimin e arrestimit/ndalimit lidhur me masën e sigurisë të caktuar me vendim nga organet e gjykatës.
 - f) Data e ora e transferimit për në IEVP apo e lënies së lirë.
- 2.24 Të njoftojë eprorët, drejtuesin e njësisë policore dhe organin e prokurorisë në rastet kur i arrestuari/ndaluari refuzon të marrë ushqimin për më shumë se 24 - orë.
- 2.25 Të vërë në dijeni eprorin direkt në rastet kur në ambientet e dhomave të sigurisë arrestohen/ndalohen persona që janë pjesëtarë apo të afërm të familjes së tij, lidhje të tjera shoqërore e miqësore.
- 2.26 **Përgjegjësit të dhomave të sigurisë i ndalohet :**
- a) Të kryejë veprimet me të ndaluarit dhe arrestuarit pa praninë e njërit prej këtyre funksioneve : specialistit/ndihmës specialist të shërbimit të Sallës Komandimit/ndihmës specialistit për informacionin, apo të një punonjësi tjetër të caktuar nga drejtuesi i shërbimeve të rendit publik, në Drejtorinë vendore të policisë/komisariatit të policisë.
 - b) Të fusë në dhomat e ndaluarve dhe arrestuarve sende të ndryshme, letra apo porosi nga të afërmit, familjarët e tyre apo persona të tjerë.
 - c) Të dorëzojë personave të tjerë çelësat e dyerve të dhomave të sigurisë.
 - d) Të kryejë veprimet me të ndaluarat dhe arrestuarat femra pa praninë dhe të një punonjësi policie tjetër i seksit femër.
 - e) Të komunikojë e zhvillojë biseda me të ndaluarit dhe arrestuarit që nuk kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave të këtij procedure.

- f) Të mbajë në këto ambiente personat e ndaluar dhe arrestuar pasi është vendosur lirimi i tyre nga organi i gjykatës apo prokurorisë ose kur përfundon afati ligjor i arrestimit/ndalimit.
- g) Të japë informacion apo të dhëna lidhur me identitetin, numrin e personave të arrestuar/ndaluar, veprat penale që kanë kryer si dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me ta - familjarëve, të afërmve apo personave të tjerë.

3. Detyrat e punonjësit të shërbimit të brendshëm.

- 3.1 Te marrë në dorëzim shtetasit e ndaluar dhe arrestuar duke i numëruar fizikisht ata e përpiluar procesverbalin përkatës.
- 3.2 Të njohë rrezikshmërinë që paraqesin të arrestuarit/ndaluarit dhe në veçanti ata që janë autorë të krimeve të rënda.
- 3.3 Të mbajë në mbikëqyrje të arrestuarit/ndaluarit, qëndrimet, veprimet apo tentativat që mund të bëjnë për tu larguar me forcë apo për tu vetë dëmtuar duke i kontrolluar ata çdo 5 minuta.
- 3.4 Për të arrestuarit/ndaluarit që janë të dehur, përdorues të drogave dhe me çrregullime/dobësi mendore ti kontrollojë jo më pak se një herë në 3 minuta.
- 3.5 Te njoftojë e kërkojë ndihmë nëpërmjet telefonit apo sinjalit të ziles : përgjegjës in e shërbimit të sallës komandimit/ndihmës specialistin për informacionin, eprorin e drejtpërdrejtë për çdo rast të ndodhjes së çrregullimeve, tentativave për largim nga këto ambiente, për vetëdëmtime apo vetëvrasje.
- 3.6 Të vërë në dijeni eprorin e drejtpërdrejtë në rastet kur në ambientet e dhomave të sigurisë arrestohen/ndalohen persona që janë pjesëtarë apo të afërm të familjes së tij e lidhje të tjera shoqërore e miqësore.
- 3.7 Te komunikojë me të ndaluarit dhe arrestuarit me etikë, kulturë, qartë saktë dhe prerë vetëm për arsye të zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.
- 3.8 Të marrë dhe transmetojë kërkesat/ankesat e të arrestuarve/ndaluarve tek përgjegjësi i shërbimit të sallës komandimit/ndihmës specialisti për informacionin dhe eprorin e drejtpërdrejtë, kur kanë nevojë për ndihmë mjekësore.
- 3.9 Të komandojë ndriçimin elektrik të ambientit ku qëndron i arrestuari/ndaluari gjatë natës në kohën e pushimit.
- 3.10 Të kryejë shërbim i pajisur me këpuce gome me qëllim që gjate lëvizjes të mos shkaktojë zhurmë në këto ambiente.
- 3.11 Të kryejë shërbim pa armatim personal dhe pa mjete të komunikimit telefonik personal.
- 3.12 **Punonjësit të shërbimit të brendshëm, i ndalohe :**
 - a) Te kryejë shërbimin duke pasur me vete armatimin personal apo sende të tjera të ndaluara nga ky procedure.
 - b) Të shkëpusë vëmendjen nga kryerja e shërbimit, të largohet nga shërbimi pa u zëvendësuar nga komanda eprore.

- c) Te lejojë komunikimin e personave të ndaluar e arrestuar midis tyre nga dhoma në dhomë me zë apo goditje në mur.
- d) Të pranojë letra, porosi, ushqime apo sende të tjera nga familjarët dhe të afërmit e shtetasve të arrestuar/ndaluar për tua dërguar këtyre të fundit, si dhe anasjelltas.
- e) Te flejë, hajë, lexojë gjatë kryerjes së shërbimit për sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve.
- f) Të japë informacion apo të dhëna lidhur me identitetin, numrin e personave të arrestuar/ndaluar, veprat penale që kanë kryer si dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me ta - familjarëve, të afërmit apo personave të tjerë.

4. Detyrat e punonjësit të shërbimit të jashtëm.

- 4.1 Te njohë mirë terrenin e objektet përreth dhomave të sigurisë, detyrën për sigurimin e jashtëm, sektorin e shërbimit, duke saktësuar zonën e lire, të ndaluar dhe kufijtë e përdorimit të armeve të zjarrit.
- 4.2 Te vrojtojë e mbajë në kontroll pa ndërprerje sektorin e shërbimit dhe të parandalojë çdo tentativë për arratisje nga dhomat e të arrestuarve dhe ndaluarve.
- 4.3 Te mos lejojë asnjë person që nuk ka lidhje me shërbimin e sistemit të dhomave të sigurisë në sektorin e shërbimit.
- 4.4 Te dijë vendndodhjen e dhomave (të dritareve) ku mbahen të arrestuarit e ndaluarit me rrezikshmëri të theksuar.
- 4.5 Për çdo veprim të dyshimtë në sistemin e dhomave të sigurisë dhe në kufijtë e ndaluar, njofton menjëherë eprorët, përgjegjësi e shërbimit dhe shërbimin e sallës së drejtimit e komandimit.
- 4.6 Të kryejë shërbim me armatim personal brezi dhe krahu (automatik dhe pistoletë) me kompletin e përcaktuar të fishekëve.
- 4.7 Gjatë kohës së caktuar për sigurimin e të arrestuarve dhe ndaluarve që dalin në ajrim ti mbajë nën kontroll të plotë për të parandaluar çdo tentativë apo mundësi për tu larguar e arratisur nga këto ambiente.
- 4.8 Kur konstaton daljen e të arrestuarve dhe ndaluarve nga dhomat nëpërmjet çarjes së mureve, dritareve apo formave të tjera të kundërligjshme të përdorë armën në bazë të ligjit 72/2014“Për përdorimin e armëve të zjarrit”, për të parandaluar largimin nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm të personit që paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që nuk u bindet urdhrave të ligjshëm të dhënë nga punonjësi i policisë
- 4.9 Në përfundim të shërbimit të përpilojë raportin ditor të punës/shërbimit për gjithë problemet apo shqetësimet që ka pasur në shërbim.
- 4.10 **Punonjësit të shërbimit të sigurimit të jashtëm i ndalohe :**
 - a) Të largohet nga sektori i shërbimit pa u zëvendësuar më parë nga personi përgjegjës direkt i shërbimit.
 - b) Të largojë vëmendjen nga sektori i shërbimit dhe të hyj në biseda me persona të tjerë.

- c) Të komunikojë me të arrestuarit/ndaluarit nëpërmjet dritareve për probleme që nuk kanë lidhje me zbatimin e rregullave të këtij procedure.
- d) Të flejë, të hajë, të ulet apo shtrihet, të lexoje, si dhe të mbajë armën në kundërshtim me rregullat e caktuara për shërbim.
- e) Të japë informacion apo të dhëna lidhur me identitetin, numrin e personave të arrestuar/ndaluar, veprat penale që kanë kryer si dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me ta - familjarëve, të afërmve apo personave të tjerë.

5. Vlerësimi i rrezikut në ambientet e dhomave të sigurisë.

- 5.1 Për çdo të arrestuar/ndaluar menjëherë pas marrjes së kësaj mase kryhet dhe vlerësimi e përcaktimi i rrezikut.
- 5.2 Vlerësimi i rrezikut për të arrestuarin/ndaluarin kryhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë në bashkëpunim me :
 - a) Oficerin e policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin/ndalimin.
 - b) Drejtues apo specialistë të shërbimeve për krimet dhe ato të luftës kundër krimeve të rënda dhe krimet të organizuar në drejtorinë vendore të policisë apo komisariatit e policisë.
- 5.3 Në vlerësimin e përcaktimin e rrezikut mbahen parasysh; vepra penale që ka kryer personi, rrezikshmëria që paraqet, nëse është përsëritës në krim, nëse është përdorues i drogave, tendenca që mund të ketë për të kundërshtuar e kryer veprime të dhunshme ndaj personelit të shërbimit policor, konfliktet që mund të ketë me persona të tjerë të arrestuar/ndaluar në dhomat e sigurisë apo persona të tjerë jashtë, si dhe çdo e dhënë apo informacion për personin që vlerësohet si e nevojshme për të përcaktuar rreziqet e mundshme.
- 5.4 Në bazë të dhënave të grumbulluara dhe rrezikshmërisë që paraqet personi konkret, merren dhe zbatohen masat për sigurimin e tij e parandalimin e ngjarjeve me pasoja në këto ambiente.
- 5.5 Përgjegjësi i dhomave të sigurisë sipas rrezikshmërisë së përcaktuar për të arrestuarin, bën shënimet përkatëse në Librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit në dhomat e sigurisë, duke lënë detyra përkatëse si dhe udhëzuar punonjësit e policisë për çdo ndërresë shërbimi.
- 5.6 Për personat e dënuar me vendim të formës së prerë në mungesë me 25 vjet burgim dhe burgim të përjetshëm, deri në transferimin e tyre në IEVP, ruhen me shërbim fiks të palëvizshëm me punonjës policie.

6. Pajisjet e sigurisë/monitorimit audio - vizive.

- 6.1 Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të dhomave të sigurisë vendosen pajisje sigurie (sisteme kamerash audio - vizive) për monitorimin e ambienteve dhe të veprimeve të punonjësve të policisë me të arrestuarit/ndaluarit si çdo aktivitet tjetër në këto ambiente.

- 6.2 Pajisjet e sigurisë audio - vizive vendosen në ambientet e më poshtme :
- a) Në korridorin e dhomave të sigurisë në pozicione të përshtatshme për vëzhgimin e mbajtjen në kontroll të korridorit, dyerve të dhomave të sigurisë, veprimet që kryhen me të arrestuarit/ndaluarit gjatë hyrjes e daljes në këto ambiente, shkuarjes dhe kthimit nga tualetet dhe kryeja e dushit, si dhe veprimet e punonjësit të policisë të shërbimit të brendshëm, etj.
 - b) Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit.
 - c) Në ambientet e jashtme të dhomave të sigurisë për mbajtjen në kontroll të mureve e dritareve të këtyre ambienteve.
- 6.3 Pajisjet për kontrollin, monitorimin, regjistrimin e imazheve (audio dhe video) të kamerave vendosen në ambientet e shërbimit të sallave të komandimit të drejtorive vendore të policisë/komisariateve të policisë, ose në ambiente të tjera të përcaktuara me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

XV. PROCEDURAT PER EVIDENTIMIN DHE TRAJTIMIN E KËRKESË/ANKESAVE TË PERSONAVE TË SHOQËRUAR, TË NDALUAR DHE TË ARRESTUAR

1. Parime të përgjithshme

- 1.1 E drejta për të paraqitur ankesë/kërkesë është një e drejtë themelore, universale dhe kushtetuese për të gjithë personat përfshi këtu dhe ata të privuar/kufizuar nga liria, nga ana tjetër kjo e drejtë është dhe një detyrim i Policisë së Shtetit, strukturave të tjera shtetërore dhe atyre të pavarura që të marrin masa për mbrojtjen efektive të të drejtave të personave të privuar nga liria duke evidentuar, trajtuar dhe zgjidhur ankesë/kërkesat që bëhen nga personat e kësaj kategorie lidhur me kushtet e qëndrimit dhe trajtimin që u bëhet nga personeli policor.
- 1.2 Kjo e drejtë gjen pasqyrim në konventat ndërkombëtare të OKB-së dhe Këshillit të Evropës si: Konventa e OKB-së Kundër Torturës (CAT), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e Degraduese, Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Trajtimin e Personave të Privuar nga Liria, Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit tonë.

2. E drejta për të paraqitur ankesë/kërkesë dhe subjektet që gëzojnë këtë të drejtë

2.1 Detyrimet e Policisë së Shtetit për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar / arrestuar:

- a) Punonjësit e Policisë së Shtetit në veprimtarinë e përditshme për ruajtjen e rendit, sigurisë publike dhe përmbushjen e përgjegjësive të Policisë së Shtetit ushtrojnë atributet e tyre ligjore për shoqërimin, arrestimin, ndalimin, si dhe mbajtjen e trajtimin e personave në ambientet përkatëse të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë.

- b) Mbajtja dhe trajtimi i personave në ambientet e policisë, kryhet brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj, si:
 - b.1** Të shoqëruarit mbahen dhe trajtohen deri në sqarimin e shkakut të shoqërimit apo të pozitës që kanë në raport me ngjarjet kriminale, prishjet e rendit publik e çdo veprimtari tjetër të kundërligjshme - deri në 10 orë.
 - b.2** Të ndaluarit/arrestuarit mbahen dhe trajtohen në ambientet e policisë deri në shqyrtimin dhe caktimin e masës së sigurisë nga gjykata, kohë e cila nuk mund t'i kalojë 96 orë nga koha e ndalimit/arrestimit që ka kryer policia gjyqësore.
- c) Mbajtja dhe trajtimi i këtyre personave në ambientet e policisë përbën kufizim/privim të lirisë, i cili duhet të kryhet sipas përcaktimeve dhe procedurave ligjore. Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, kësaj kategorie personash u njohin një sërë të drejtash, për të cilat Policia e Shtetit ka detyrimin ligjor që t'i respektojë dhe të garantojë kushtet dhe mundësitë për ushtrimin dhe realizimin e tyre. Ngritja dhe funksionimi i një mekanizmi të brendshëm efektiv dhe të pavarur për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të personave të privuar nga liria (të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar) si dhe monitorimi i zbatimit të këtij procesi është një element i rëndësishëm për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të kësaj kategorie personash.
- d) Për çdo të arrestuar/ndaluar menjëherë pas hyrjes dhe akomodimit në ambientet e dhomave të sigurisë u bëhen të njohura të drejtat ligjore që kanë, sipas formatit të "Deklaratës Tip" të miratuar për këtë qëllim, një kopje e së cilës u jepet të arrestuarve/ndaluarve dhe kopja tjetër administrohet nga personeli përgjegjës i dhomave të sigurisë.
- e) Në rastet kur i arrestuari/ndaluari paraqet ankesë/kërkesë me shkrim por të mbyllur, personeli policor merr masa për t'i vënë në dispozicion zarfe për mbylljen e ankesë/kërkesës.

3. Të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar për të bërë ankesë/kërkesë:

- 3.1 Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t'u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore.
- 3.2 Çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të Ligjit "Për Policinë e Shtetit" ose u cenohen liritë dhe të drejtat e tyre kanë të drejtë t'u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore.
- 3.3 Çdo person që shoqërohet nga policia sipas rasteve të parashikuara në Ligjin 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës në çdo kohë.

4. Institucionet dhe autoritetet që ju drejtohet ankesë / kërkesa

Personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar që mbahen në ambientet e Policisë së Shtetit, kërkesë/ankesat e tyre i drejtojnë në:

- 4.1 Institucionet shtetërore dhe drejtuesve të tyre, si :

- a) Drejtuesve të njësisë policore ku ndodhet i shoqëruari, ndaluar/arrestuari.
- b) Drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit.
- c) Drejtuesve të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe strukturave në varësi të Ministrit të Punëve të Brendshme.
- d) Ministrit të Drejtësisë.
- e) Kryeministrit.

4.2 Institucionet e pavarura dhe kushtetuese si:

- a) Institucionit të Prokurorisë sipas shkallëve të gjyqësorit dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.
- b) Gjykatës, sipas shkallëve të gjyqësorit.
- c) Avokatit të Popullit.
- d) Presidentit të Republikës.

4.3 Organizatat e shoqërisë civile (vendase apo të huaja) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si:

- a) Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- b) Instituti Evropian i Tiranës.
- c) Qendra për Rehabilitimin e Torturës dhe Traumës.
- d) Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci.
- e) Etj.

4.4 Format/mënyrat e paraqitjes së kërkesë/ankesës, janë:

- a) Me gojë/verbalisht.
- b) Me shkrim e cila mund të jetë e hapur por dhe e mbyllur në zarf.
- c) Me telefon, me SMS, me shkrim në adresat zyrtare elektronike të institucioneve shtetërore si dhe në adresat e drejtuesve të këtyre institucioneve.

4.5 Nisur nga pozita, kushtet dhe statusi që kanë personat e privuar nga liria (të arrestuar/ndaluar dhe të shoqëruar) si dhe koha relativisht e shkurtër e mbajtjes e trajtimit të tyre në ambientet e policisë, format më të aplikueshme të paraqitjes së ankesë/kërkesave janë ato me shkrim dhe me gojë/verbalisht.

4.6 Ankesë/kërkesa mund t'i paraqitet drejtpërdrejt dhe personalisht drejtuesit të njësisë policore (shefit të komisariatit të policisë ose drejtorit të drejtorisë vendore të policisë) si dhe stafit tjetër policor që kryejnë detyra për menaxhimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve dhe të arrestuarve.

4.7 Kur i arrestuari/ndaluar dhe i shoqëruari kërkon të bëjë një ankesë/kërkesë dhe këtë dëshiron që t'ia paraqesë verbalisht dhe personalisht titullarëve të njësisë policore apo stafit tjetër policor, merren masa për:

- a) Njoftimin dhe vënien në dijeni të titullarit apo personit tjetër policor të njësisë për kërkesën që ka i arrestuari/ndaluar për të takuar drejtuesin e njësisë policore.
- b) Realizimin e takimit të drejtuesit apo atij që e zëvendëson me personin e arrestuar/ndaluar që kërkon këtë takim menjëherë por jo më vonë se 6 orë nga paraqitja e kërkesës.

- c) Realizimin e takimit dhe të bisedës pa praninë e personave të tjerë, me përjashtim të rasteve të veçanta për efekte sigurie.

5. Rregullat dhe procedurat për marrjen, evidentimin dhe trajtimin e ankesë/kërkesave:

Ankesë/kërkesat e të arrestuarve/ndaluarve dhe shoqëruarve bëhen në çdo kohë tek personeli policor që kryen detyra për ruajtjen, trajtimin e mbikëqyrjen e tyre.

5.1 Evidentimi i kërkesë/ankesave të paraqitura me gojë/verbalisht:

- a) Punonjësi i policisë të cilit i paraqitet ankesa/kërkesa ka për detyrë të sqarojë dhe marrë të dhënat përse bën fjalë ankesa/kërkesa si: kur ka ndodhur ngjarja, veprimi apo mosveprimi i kryer, në çfarë rrethanash ka ndodhur, të dhëna për personin që ka vepruar apo nuk ka vepruar, dëmtime apo shenja (nëse ka), persona që kanë parë këtë veprim apo ngjarje etj.
- b) Njofton menjëherë eprorin direkt të tij për ankesë/kërkesën dhe më pas shefin e seksionit të patrullës përgjithshme / rendit publik dhe shefin e sektorit të forcës së posaçme të shoqërimit dhe sigurisë në D.V.P. Tiranë.
- c) Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrit.

5.2 Evidentimi i ankesë/kërkesave të paraqitura me shkrim (të hapura dhe të mbyllura):

Pas paraqitjes dhe marrjes së kërkesë/ankesës me shkrim, punonjësi i policisë që i paraqitet kërkesë/ankesa merr këto masa:

- a) Dorëzon ankesën/kërkesën e shkruar tek eprori i drejtpërdrejt i tij dhe më pas ky i fundit tek drejtuesi i njësisë policore.
- b) Kryen plotësimin e të dhënave në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan në rubrikën përkatëse. Modeli i Regjistrit të evidentimit të ankesë/kërkesave për personat e privuar nga liria është sipas modelit bashkëlidhur dhe pjesë e kësaj procedure.
- c) Drejtuesi i njësisë policore urdhëron dhe monitoron kryerjen e veprimeve në protokoll/arshivën e njësisë për protokollimin e ankesë/kërkesës.
- d) Nëse ankesë/kërkesa i drejtohet institucioneve të tjera shtetërore, institucioneve kushtetuese/të pavarura apo OJQ/OJF për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, merren masa për dërgimin zyrtarisht të ankesë/kërkesë në institucionin përkatëse që adresohet, e shoqëruar me një shkresë përcjellëse të njësisë policore.
- e) Për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave që i drejtohen drejtuesve të njësisë policore ku ndodhet i shoqëruari, ndaluari apo i arrestuari, ndiqen këto procedura :

e.1 Vihet në dijeni titullari i njësisë policore për ankesë/kërkesën e bërë (si verbalist apo dhe me shkrim) nga i shoqëruari, i ndaluar apo i arrestuari.

e.2 Verifikimi dhe trajtimi i ankesë/kërkesës që i drejtohet titullarit të njësisë policore kryhet nga vetë titullari ose duke ngarkuar punonjës të tjerë të policisë për këtë qëllim.

e.3 Punonjësi i policisë i ngarkuar për trajtimin e kërkesë/ankesës sipas natyrës dhe objektit të ankesë/kërkesë merr masa për këqyrjen e të dhënave dhe fakteve të pasqyruara në regjistra, libra shërbimi, raporte shërbimi, procesverbale; interviston vetë ankuesin dhe persona të tjerë që mund të kenë qenë të pranishëm si dhe punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet me personin ankues.

e.4 Në përfundim, punonjësi i policisë përpilon një informacion të hollësishëm për titullarin e njësisë policore të shoqëruar me kopje të akteve apo dokumenteve që vërtetojnë se ankesa qëndron ose është e rreme (e pa vërtetë).

6 Konfirmimi për paraqitjen e dorëzimin e ankesë/kërkesës:

6.1 Pas paraqitjes dhe evidentimit të kërkesë/ankesës është e detyrueshme që ankuesi të pajiset nga njësia policore me një vërtetim apo dokument që vërteton paraqitjen apo bërjen e kërkesë/ankesës në njësinë përkatëse policore.

6.2 Ky vërtetim plotësohet nga punonjësi i policisë të funksionit:

- a) Shef seksioni i patrullës së përgjithshme/rendit publik në komisariatet e policisë.
- b) Shefi i seksionit të shoqërimit dhe sigurisë, në D.V.P Tiranë.

6.3 Vërtetimi plotësohet në dy kopje, nënshkruhet nga titullari i njësisë policore, protokollohet dhe i jepet kërkuesit/ankuesit.

6.4 Plotësimi dhe dhënia e kopjes të vërtetimit të paraqitjes së kërkesë/ankesës kryhet menjëherë pas evidentimit të saj por jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë orë).

6.5 Tipi dhe modeli i vërtetimit që lëshohet në këto raste është sipas formatit "*Model - 1*" dhe "*Model - 1.1*", bashkëlidhur dhe pjesë e kësaj procedure.

7 Vlerësimi dhe trajtimi i kërkesë/ankesave të shoqëruarve, ndaluarve dhe të arrestuarve

7.1 Drejtuesi i njësisë policore pas njohjes me kërkesë/ankesën kryhen vlerësimin e saj nëse kemi të bëjmë me veprime apo mosveprime që përbëjnë vepër penale, apo shkelje të tjera që përbëjnë shkelje disiplinore të kryera nga personeli policor apo jo policor i Policisë së Shtetit.

- 7.2 Në rastet kur vlerësohet se ankesa përmban elementë të një vepre penale, zbatohen këto masa:
- a) Njoftohet organi i prokurorisë dhe strukturat e SHÇBA-së të juridiksionit përkatës të D. V. Policisë për të kryer veprimet procedurale.
 - b) Vihen në dispozicion të SHÇBA-së personeli përkatës që ka kryer apo ka dijeni për veprën penale, dokumentacionin përkatës e çdo gjë tjetër e nevojshme për sqarimin e vërtetimin e rrethanave.
 - c) Ndaj punonjësit të policisë përgjegjës në ngarkim të të cilit zhvillohen hetimet merren masat sipas kërkesave të Rregullores së Policisë së Shtetit.
- 7.3 Në rastet kur veprimet e mosveprimet e paraqitura në ankesë/kërkesë nuk kanë elementët e figurës të veprës penale por shkelje të rregullave të punës dhe disiplinës, procedohet sipas përcaktimeve të rregullores të Policisë së Shtetit për dhënien e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës.

8 Afatet dhe forma e informimit/kthimit të përgjigjes për kërkuesin/ankuesin.

- 8.1 Për kërkesë/ankesat e drejtuara titullarëve të njësive policore dhe që nuk kërkojnë një kohë të konsiderueshme për verifikimin e trajtimin e saj (kur shkelja është dukshme dhe lehtësisht e verifikueshme), afati i trajtimit dhe kthimit të përgjigjes ndaj ankuesit është jo më vonë se 24 orë nga koha e paraqitjes së saj.
- 8.2 Në të gjitha rastet kur kërkesë/ankesa i drejtohet drejtuesve të njësive policore në komisarariatet dhe drejtoritë vendore të policisë dhe nuk kemi të bëjmë me kryerje të veprave penale, afati i kthimit të përgjigjes për të interesuarin është jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së ankesë/kërkesës.
- 8.3 Për rastet kur ankesë/kërkesa i drejtohet strukturave të Drejtorisë të Policisë së Shtetit, strukturave të tjera shtetërore, institucioneve të pavarura dhe OJQ/OJF, afati i kthimit të përgjigjes është sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore për informimin.
- 8.4 Kthimi i përgjigjes për kërkuesin/ankuesin realizohet verbalisht dhe me shkrim, sipas formës së paraqitur.
- 8.5 Në rastet kur ankesa është paraqitur me gojë/verbalisht drejtuesve të njësive policore dhe ankuesi nuk ndodhet në ambientet e policisë (është lënë i lirë, është transferuar në IEVP) kthimi i përgjigjes kryhet me shkrim dhe dërgohet zyrtarisht me postë në adresën e qëndrimit, vendbanimit apo IEVP-në ku është transferuar ankuesi.
- 8.6 Pas informimit dhe kthimit të përgjigjes, kërkuesi/ankuesi ka të drejtë që në çdo kohë të ankimobjë këtë përgjigje në një strukturë eprorë apo më të lartë të njësive policore që ka trajtuar kërkesë/ ankesën.

9 Monitorimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave.

9.1 Përgjegjësinë për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave vendore për pranimin, verifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesë/kërkesave të bëra nga personat e privuar nga liria e kanë strukturat qendrore të Drejtorisë të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

XVI. SHTOJCA TË PROCËDURËS

1. Pjesë përbërëse e kësaj procedure janë :

- 1.1 Të gjitha skicat/projektet tip dhe specimentet teknike për sistemin e dhomave të sigurisë, ambientet e qëndrimit dhe të paradhomës, dritares të dhomave të sigurisë, zgarës së hekurit ndarëse të ambientit të qëndrimit me atë të paradhomës, të krevatit të fjetjes, etj bashkëlidhur.
- 1.2 Modelet e regjistrave, deklaratës dhe vërtetimeve “Tip”, bashkëlidhur.

=====

VO. Modelet e dhomave ,dyerve,dritareve, zgarave , sipas lidhjeve të miratuara pjesë e pandare te këtij Urdhri,nr 1102 date 07.11.2017

(Model 1)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë

Nr. _____ Prot. _____, më __. __. 20__

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se shtetasi _____, i datëlindjes __. __. ____,
banues në adresën: _____, më
datën __. __. 20__, ka paraqitur ankesë/kërkesë pranë Drejtorisë Vendore të
Policisë _____.

Ankesa/kërkesa është bërë gjatë kohës së qëndrimit të këtij shtetasi në ambientet e
policisë si i shoqëruar/arrestuar/ndaluar, e cila është e regjistruar me nr. _____, në
regjistrin përkatës.

Drejtör Vendor i Policisë

Model 1/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDHSME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë
Komisariati i Policisë

Nr. _____ Prot.

_____, më __. __. 20__

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se shtetasi _____, i datëlindjes __. __. ____,
banues në adresën: _____, më
datën __. __. 20__, ka paraqitur ankesë/kërkesë pranë Komisarariatit të Policisë
_____.

Ankesa/kërkesa është bërë gjatë kohës së qëndrimit të këtij shtetasi në ambientet e
policisë si i shoqëruar/arrestuar/ndaluar, e cila është e regjistruar me nr. _____, në
regjistrin përkatës.

Shef i Komisarariatit të Policisë

(Model "3")

DEKLARATE

PËR INFORMIMIN DHE NJOHJEN ME TË DREJTAT LIGJORE, PËR PERSONAT E ARRESTUAR/NDALUAR, NË POLICINË E SHTETIT

_____, data, _____.20____, ora _____.

Unë (emri, mbiemri i të arrestuarit/ndaluarit) _____, i datëlindjes _____.____.____, i biri _____, lindur në _____ dhe banues në adresën: _____, deklaroj se jam njohur me të drejtat ligjore që kanë personat e arrestuar/ndaluar, gjatë arrestimit/ndalimit dhe qëndrimit në dhomat e sigurisë të policisë, si vijon :

1. Të njihet me shkakun dhe arsyen e arrestimit apo ndalimit.
2. Nuk ka detyrim të bëjë deklarata dhe n.q.s do të flasë e çfarëdo që të thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim.
3. Të mbrohet e përfaqësohet me avokat, duke e zgjedhur vetë, por jo më shumë se dy mbrojtës, ose të caktuar nga prokurori sipas përcaktimeve të nenit 255 të K. Pr. Penale.
4. Të miturve u sigurohet asistencë dhe ndihma e një psikologu gjatë arrestimit/ndalimit dhe qëndrimit në këto ambiente.
5. Të njoftojë një pjesëtar të familjes, një të afërm apo persona të tjerë të zgjedhur prej tij për situatën dhe vendndodhjen. Për personat e mitur, të njoftohet detyrimisht personi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij apo mbrojtësi ligjor (edhe kur një gjë e tillë refuzohet nga i mituri).
6. Ti nënshtrohet vizitës dhe kontrollit mjekësor të një mjeku/ndihmës mjeku të policisë apo të tjerë të zgjedhur dhe shpërblyer nga i arrestuari/ndaluari, menjëherë pas arrestimit/ndalimit, si dhe gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e sigurisë.
7. Të merret në pyetje nga përfaqësuesit e organit të akuzës (prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore) në prani të mbrojtësit të zgjedhur apo të caktuar nga prokurori.
8. Të marrë takim në çdo kohë me avokatin mbrojtës, kujdestarin ligjor, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, etj - sa herë që kërkohet nga këta të fundit.
9. Shtetasit e huaj të marrin kontakt me përfaqësues të Përfaqësisë Diplomatike të vendit të tij dhe në mungesë të tyre me përfaqësues të atij shteti që ka marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shtetit përkatës.
10. Personat e mitur të mbahen e trajtohen në dhomë më vete, të ndarë nga të rriturit.
11. Të trajtohet në mënyrë njerëzore, dinjitoze dhe pa diskriminim.
12. Të paraqesë ankesa e pretendime tek drejtuesit e policisë, institucione të tjera shtetërore dhe organizma të pavarura, për shkelje, mosrespektim apo dhunim të drejtave nga personeli policor.

Deklaruesi
(i arrestuari/ndaluari)

VO. Modelet e dhomave ,dyerve,dritareve, zgarave , sipas lidhjeve te miratuara pjese e pandare te këtij Urdhri

